

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6370
E shtunë, 24 korrik 2021
çmimi 0.40 €

MASHTI po i bën përgatitjet
që viti i ri shkollor
të fillojë me kohë | FAQE 7



FLET PËR "EPOKËN E RE", IBRAHIM GASHI | FAQE 4-5

DIPLOMACIA ËSHTË PARAQITUR KEQ



Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka thënë se diplomacia në këtë qeveri është duke u paraqitur keq. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka theksuar se ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, disa herë ia ka huq keq në paraqitjet në rrjete sociale dhe në media. Gashi ka vlerësuar se ajo si kryediplomate e vendit duhet ta mbrojë interesin kombëtar dhe jo të mbajë qëndrime personale dhe partiake. Sipas tij, qëndrimet e shefes së diplomacisë në disa forume të rëndësishme ndërkombëtare kanë qenë të patolerueshme

URDHËROHET PROKURORIA E SPECIALES QË TA PËRMIRËSOJË AKTAKUZËN NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-së | FAQE 3



KURTI U BËNË THIRRJE QYTETARËVE TË VAKSINOHEN: RREZIKOHEMI NGA PËRHAPJA E VARIANTIT 'DELTA' | FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqishti - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVO
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com
Gazeta "Epoka e re"](https://facebook.com/Gazeta%22Epoka%20e%20re%22)



OPINION

DISKRIMINIMI FLAGRANT I GJYKATËS SPECIALE NDAJ TË AKUZUARVE SHQIPTARË

F. 10
Reagim i KMDLNj-së

AKTUALE

DY SHTETE OFROJNË GARANCI PËR LIRIMIN E HASHIM THACIT NGA PARABURGIMI F. 3

RAHOVECI, KOMUNA MË TRANSPARENTE NË KOSOVË F. 6



EKONOMI

MURATI NËNSHKRUAN MARRËVESHJE PREJ 15 MILIONË EUROSH ME BANKËN BOTËRORE F. 8

MËRGATA, MOTOR I ZHVILLIMIT EKONOMIK TË KOSOVËS F. 8

SPORT

HAPET PANAIRI I LIBRIT 'FUSHË-KOSOVA 2021', EDICIONI I PARË F. 14



Dodik: Republika Sërpkska duhet ta iniciojë shpërbërjen

SARAJEVË, 23 KORRIK - Anëtari serb i Presidencës trepalëshe të Bosnjës, Millorad Dodik, ka pohuar të premtën se përfaqësuesi special i komunitetit ndërkombëtar në Bosnje, Valentin Inzko, nuk ka të drejtë të imponojë ndonjë ligj për ndalimin e mohimit të genocidit. Inzko, duke i përdorur kompetencat e Bonit që i japin të drejtë të çoje përparrë vendime, vendosi ndryshime në

Kodin Penal të Bosnjës, me të cilat ndalohet dhe dënoshet mohimi i gjenocidit dhe madhërimi i kriminelëve të luftës. "Republika Sërpkska e hedh poshtë këtë vendim. Në Srebrenicë nuk ka pasur gjenocid. Serbët nuk guxojnë ta pranojnë këtë vendim, kjo është një gozhëdë e ngulur në arkivolin e Bosnie e Hercegovinës. Pas kësaj, Bosnie e Hercegovina nuk mund të funksionojë. Do të thërrasim një seancë të

Asamblesë së Republika Sërpkska javën e ardhshme. Republika Sërpkska duhet ta fillojë procesin e shpërbërjes. Nuk ka dialog në Bosnje", ka thënë Dodik. Në vitin 1995 forcat serbe të Bosnjës kanë vrarë mbi 8 000 burra dhe djem myslimanë në Srebrenicë. Në vitin 2007 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë ka konstatuar se këto vrasje kanë përbërë gjenocid.



Mali i Zi ashpërsonte masat kundër koronavirusit



SHKUP, 23 KORRIK - Në Mal të Zi, nga 23 korriku deri më 2 gusht, do të ndalohet puna e klubave të natës dhe e diskotekave në ambiente të hapura dhe të mbyllura, bëri me dije Institutit i Shëndetit Publik në këtë vend. Vendimi u mor pas, siç u tha, rritjes së numrit të rasteve me koronavirus. Me të ndaloj edhe ahengjet dhe festivalet e muzikës, si dhe çdo tubim masiv në ambiente të mbyllura. Nga 2 gushti qëndrimi në

ambiente të brendshme të hotelisë do të lejohet vetëm për qytetarët që kanë test negativ për koronavirusin (PCR), konfirmim se janë vaksinuar me së paku dozën e parë të vaksinës ose dëshmi se janë shëruar nga koronavirusi, tha drejtori i Institutit të Shëndetit Publik në Mal të Zi, Igor Galliq. Ministria e Shëndetësisë e Malit të Zi tha se masat janë ashpërsuar për shkak të mosrespektimit të tyre, veçanërisht në qytetet

bregdetare. Sipas të dhënave të fundit, në Mal të Zi janë 480 raste aktive me koronavirus - 136 prej tyre në qytetin turistik të Budvës. Sipas të dhënave të Organizatës Kombëtare të Turizmit, në qytetet në bregdet dhe në veri të Malit të Zi aktualisht ndodhen rreth 110 mijë turistë, çfarë do të thotë 80 për qind më shumë se në vitin 2019. Turistëve të huaj u lejohet hyrja në Mal të Zi pa test PCR ose certifikatë vaksinimi.

Italia kërkon certifikatën e vaksinimit për një sërë aktivitetesh

ROMË, 23 KORRIK - Italia nga 6 gushti do ta kërkojë certifikatën e vaksinimit kundër koronavirusit për të kryer një sërë aktivitetesh. Të gjithë personat e moshës 12 vjeç e lart, që kanë marrë së paku një dozë të vaksinës, do të mund të hyjnë në disa vende, përfshirë ambientet e brendshme të restoranteve, kinematë dhe palestrat. Megjithatë, pas mosmarrëveshjeve brenda koalicionit qeveritar,

certifikata nuk do të jetë e nevojshme për transport. Rastet me koronavirus janë sërisht në rritje në Itali. Ato janë dyfishuar gjatë javës së kaluar, ndërsa mbi 5 000 janë raportuar vetëm të enjten. Rreth gjysma e italianteve janë tanë për tanë plotësisht të vaksinuar. Që nga fillimi i pandemisë, në mars të vitit të kaluar, Italia ka konfirmuar mbi 4.3 milionë raste me koronavirus dhe afro 128 000 viktima.

Edhe disa vende të tjera në Evropë, përfshirë Francën këtë javë, kanë vendosur ta kërkojnë certifikatën e vaksinimit për qasje në vende të caktuara publike. Numri i të infektuarve është në rritje gjetë si pasojë e variantit më ngjitës të koronavirusit "Delta". Organizata Botërore e Shëndetësisë ka paralajmëruar se ky variant do të bëhet dominues brenda disa muajve.



Rritet në 47 numri i të vdekurve si pasojë e vërshimeve në Indi



NEW-DELHI, 23 KORRIK - Rrëshqitjet e dheut si pasojë e shirave të fuqishëm kanë mbytur të paktën 47 persona në Indinë perëndimore, thanë zyrtarët të premtën. Më shumë se 1 000 persona që kishin mbetur të bllokuar nga vërshimet janë shpëtuar. Viktimat e rrëshqitjeve të

dheut ishin nga tre lokacione në distrikthin e Raigadit në shtetin perëndimor Maharashtra. Shumica e atyre që janë shpëtuar ishin bllokuar mbi çati ose edhe mbi autobusë nëpër autostrada. Zyrtari i qeverisë, Safar Pathak, shtoi se përvëc 47 të

vdekurve, më shumë se 30 persona janë të zhdukur pas rrëshqitjeve të dheut. Shirat sezionale monsunë nisin në qershori dhe zgjasin deri në shtator dhe çdo vit, në shtetet e Azisë Qendrore ato shkaktojnë viktima. Por, India është shteti më i goditur nga monsunet.

Urdhërohet Prokuroria e Speciales që ta përmirësojë aktakuzën ndaj ish-krerëve të UÇK-së

Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen gjyqësore Thaqi dhe të tjerët ka marrë vendim lidhur me micionet paraprake të dorëzuara nga të katër akuzuarit kundër juridikacionit. Sipas vendimit, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) urdhërohet që deri më 3 shtator të dorëzojë një version të korriguar të aktakuzës ndaj ish-krerëve të UÇK-së

EPOKA
ERE**Muhamed KOCI**

PRISHTINË, 23 KORRIK - Gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, ka miratuar pjesërisht micionet e mbrojtjes së Hashim Thaqit, Kadri Veselit, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi kundër formës së aktakuzës.

Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë kanë bërë me dije se gjykatësi Nicolas Guillou ka urdhëruar Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) që deri më 3 shtator të dorëzojë një version të korriguar të aktakuzës së konfirmuar në pajtim me vendimin. "Më 22 korrik Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen gjyqësore Thaqi dhe të tjerët lëshoi vendimin e tij lidhur me micionet paraprake të dorëzuara nga të katër të akuzuarit kundër juridikacionit të Dhomave të Specializuara. Gjykatësi miratoi pjesërisht micionin e Veselit dhe urdhëroi ZPS-në që të paraqesë një aktakuzë të ndryshuar duke përjashtuar formën e zjerauer të përgjegjësisë së ndërmarrjes kriminale të përbashkët (e njohur si "NKP III") për krime me synim konkret. Micionet e mbrojtjes u hodhën poshtë në të gjitha pikat e tjerë", eshtë thënë në njoftimin e

bërë nga Dhomat e Specializuara. Sipas këtij njoftimi, një pjesë e micioneve të mbrojtjes eshtë hedhur poshtë. "Gjithashtu, gjykatësi lëshoi vendimin në lidhje me micionet e mbrojtjes kundër formës së aktakuzës. Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi pjesërisht micionet e Thaqit, Selimi, Jakup Krasniqi dhe urdhëroi ZPS-në që deri më 3 shtator të dorëzojë një version të korriguar të aktakuzës së konfirmuar në pajtim me vendimin. Pjesët e tjera të micioneve të tyre u hodhën poshtë dhe micioni i Veselit u hodh poshtë tërësisht", eshtë thënë në njoftimin e Dhomave të Specializuara.

Që nga nëntori i vitit 2020 ish-udhëheqësit e UÇK-së, Hashim Thaqi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi, gjenden në paraburgim në Hagë dhe janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që rëndojnë ndaj tyre. Sipas aktakuzës, Thaqi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi dyshohen për veprat penale që kanë të bëjnë me krime lufte: ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme dhe krime kundër njerëzimit: burgosje, akte të tjera çnjerëzore, zhdukje me forcë të personave dhe përndekje, të cilat, sipas



Dhomave të Specializuara, janë kryer midis marsit të vitit 1998 dhe shtatorit 1999. Prokuroria e Specializuar dhe Këshilli i Specializuar i Kosovës,

me selinë e saj në Hagë, nga 26 korriku deri më 16 gusht do të kenë pushim veror në punën e tyre. Sipas këtyre institucioneve, asnjë konferencë statusore nuk

do të mbahet gjatë kësaj periudhe, madje nuk do të merren vendime në procedurë, përvèç ndonjë vendimi që rezulton të jetë urgjent.

Dy shtete ofrojnë garanci për lirimin e Hashim Thaqit nga paraburgimi

Mbrojtja e Hashim Thaqit, përmes një parashtruese drejtuar gjykatësit paraprak, ka bërë me dije se dy shtete të treta kanë garantuar përlirimin e përkohshëm të tij në territorët e tyre, duke kërkuar lirimin e tij në një nga këto shtete. Sipas kësaj shkresë, më 5 maj 2021 mbrojtja mori garancinë me shkrim të qeverisë përlirimin e përkohshëm të Thaqit në territorin e saj, ndërsa thuhet se garanci tjetër me shkrim nga një qeveri që nuk emërhohet u mor më 14 qershor 2021. "Të dy

shtetet e treta garantojnë që të bashkëpunojnë plotësisht përlirimin e Thaqit ashtu si dhe kur kërkohet nga Dhomat e Specializuara", thuhet në këtë parashtesa.

Sipas mbrojtjes së Thaqit, ofertat nga shtetet e tretë, të mbështetura nga garancitë me shkrim, zhvendosin ekuilibrin në favor të lirimit të përkohshëm dhe këto garanci janë të mjaftueshme përlirimin e Thaqit në një qeveri që nuk emërhohet u mor më 14 qershor 2021. "Të dy

paraprake konsideron që Thaqi vazhdon të gjëzojë çdo masë të "ndikimit dhe autoritetit", kjo eliminohet tërësisht nga garancitë e shteteve të tretë, të cilat eliminojnë çdo rrezik real të pengesave ose ikjes. Mbrojtja i ka kërkuar gjykatësit të procedurës paraprake që t'i kërkojë pikëpamjet e qeverive mbi lirimin e Thaqit në territorët e tyre përkatëse dha urdhërojë lirimin e përkohshëm të Thaqit në një që këto shtete të tretë me kushtet tilla që konsiderohen të përshtatshme.

Diskriminimi flagrant i Gjykatës Speciale ndaj të akuzuarve shqiptarë

Reagimi i KMDLNJ-së

Së fundi, një ndër të akuzuarit nga Gjykata Speciale, z. Kadri Veseli, kërkoi që të gjitha materialet që kanë të bëjnë me rastin e tij të përkthehen në gjuhën shqipe në mënyrë që ta përgatitë mbrojtjen e që deri më tanë kjo e drejtë elementare e njeriut në përgjithësi dhe e drejtë e personave të privuar nga liria, në veçanti vetëm pjesërisht ishte përbushur ose ishte përbushur me vonesë të madhe që ka ndikuar në cilësinë e përgatitjes së mbrojtjes.

KMDLNJ edhe më parë ka reaguar përfaktin se, edhe në vendimet përkthimi të aktakuzës, përkthimi në gjuhën shqipe ka qenë jo i plotë dhe ishte bërë me vonesë. Gjykata Speciale pati dalë me një sqarim se materialet gjyqësore po



gjithmonë kur ka interes, duhet ta ketë të qartë se gjuhët zyrtare të Kosovës janë gjatha shqipe, serbe dhe të komuniteteve të tjera ku përbëjnë shumicën dhe, në raste të veçanta në gjuhën angleze. Gjykata Speciale po e bënë të kundërtën, të gjithë materialet i përkthen në gjuhën shqipe.

Eshtë kundër të drejtave të njeriut që përkthimi gjatë seancës të jetë në gjuhën shqipe, kurse materialet që duhen për seancë nuk u dorëzohen

të akuzuarve paraprakisht në gjuhën shqipe. Madje as vendimi përvazhdimin e paraburgimit nuk iu dorëzohet në kohë palëve në gjuhën shqipe sikur as kundërshtimi i avokatëve mbrojtës nuk iu dorëzohet me kohë të akuzuarve. Sipas Rregullores së Gjykates Speciale, gjykatësi i procedurës e cakton gjuhën që përdoret e që eshtë gjuhë angleze. Me këtë diskriminim flagrant që iu

bëhet të akuzuarve me mospërkthim me kohë të gjithë materialit në gjuhën shqipe, përvèç se shkelet Ligji për Gjuhë i Republikës së Kosovës, Gjykata Speciale e pamundëson mbrojtjen efektive të të akuzuarve e cila nuk mund të bëhet pa bashkëpunim i akuzuar-avokat, nuk siguron një proces të drejtë gjyqësor dhe nuk trajton njëjtë palët në procedurë.

Sipas ligjeve të Kosovës, të gjithë materialet fillimisht përkthehen në gjuhën shqipe, serbe dhe të komuniteteve tjera ku përbëjnë shumicën dhe, në raste të veçanta në gjuhën angleze. Gjykata Speciale po e bënë të kundërtën, të gjithë materialet i përkthen në gjuhën angleze dhe në raste të veçanta në gjuhën shqipe. Për KMDLNJ-në kjo eshtë shkelje flagrante e të drejtave të njeriut, pa asnjë dyshim.



FLET PËR "EPOKËN E RE", IBRAHIM GASHI

Diplomacia ka performuar keq

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka thënë se diplomacia në këtë qeveri është duke u paraqitur keq. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka theksuar se ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, disa herë ia ka huq keq në paraqitjet në rrjete sociale dhe në media. Gashi ka vlerësuar se ajo si kryediplomate e vendit duhet ta mbrojë interesin kombëtar dhe jo të mbajë qëndrime personale dhe partiake. Sipas tij, qëndrimet e shefes së diplomacisë në disa forume të rëndësishme ndërkombëtare kanë qenë të patolerueshme

EPOKA
ERE

Muhamed KOCI

Prishtinë, 23 korrik - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka kritikuar diplomacinë e Kosovës. Ai ka thënë se Ministria e Punëve të Jashtme dhe diplomacia e Kosovës gjatë 4-5 vjetëve të fundit nuk ka treguar performance të mirë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Gashi ka thënë se kjo traditë nuk ka ndryshuar as në qeverinë Kurti 2. "Ministria e Punëve të Jashtme dhe diplomacia e Kosovës ka një kohë relativisht të gjatë (4-5 vjetët e fundit) që nuk është duke treguar paraqitje të mirë. Qeveria Kurti 2, si duket, nuk e ka prioritet rregullimin e kësaj ministrie. Edhe ministria aktuale, pavarësisht prej respektit për 'backgroundin' e saj familjar, ka pasur performance të dobët".

dobët", ka thënë Gashi.

Ai ka deklaruar se ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ia ka huq keq në disa raste. Sipas tij, kryediplomatja e vendit disa herë ka mbajtur qëndrime personale dhe partiake karshi interesave të vendit. "Sa iu përket deklaratave të saj, ministria Gërvalla jo rrallëherë ia ka huq keq, duke mbajtur qëndrime personale dhe partiake karshi çështjeve që mund të cilësohen të interesit nacional, të cilat ajo do të duhej t'i mbronte. Ka mbajtur qëndrim të butë, me tone pajtuese me homologun serb në fjalimin e saj në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Madje duke mos i njojur faktet historike, e ka paraqitur edhe palën serbe viktivë të gjenocidit. Kjo është e patolerueshme", ka thënë Gashi, duke shtuar se edhe kualifikimet e saj për realitetin në Kosovë të

mbajtur para institucioneve të BE-së nuk kanë qenë në përporthje me vlerësimet dhe raportet ndërkombëtare për Kosovën. Ai ka shtuar se MPJ-ja duhet të jetë lokomotiva që çon përparrë afirmimin e Kosovës si shtet. "Diplomaci konvencionale shumë aktive, diplomaci publike dhe lobing të fuqishëm për të arritur njohje të reja dhe anëtarësimë të reja. Promovim të aseteve ekonomike të Kosovës tek investitorët e huaj. MPJD-ja duhet të jetë edhe një lloj rregulatori për punën e ministrive të tjera, për ta rritur eficencën e punës së tyre, në çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e një mjedisë miqësor për investitorët dhe firmat e huaja që duan të investojnë në Kosovë", ka thënë Gashi.

"**Epoka e re**": Z. Gashi, qeveria Kurti ka mbushur 100 ditë të

punës. Cili është vlerësimi juaj për politikën e Jashtme të Kosovës gjatë kësaj periudhe kohore?

Gashi: Ministria e Punëve të Jashtme dhe diplomacia e Kosovës ka një kohë relativisht të gjatë (4-5 vjetët e fundit) që nuk është duke treguar performance të mirë. Qeveria Kurti 2, si duket, nuk e ka prioritet rregullimin e kësaj ministrie. Edhe ministria aktuale, pavarësisht prej respektit për 'backgroundin' e saj familjar, ka pasur performance të dobët. Ajo fillimisht, pas marrjes së detyrës, kishte një intervistë mjaft të ekuilibruar dhe të arsyeshme, duke deklaruar se do të kërkojë kohën e duhur për të studiuar se çfarë duhet ndryshuar në MPJ dhe në shërbimin diplomatik dhe konsullor. Unë kisha një fije optimizmi se ajo do të merrej me riparimin e veprimeve jo të duhura të kryera nga pararendësit e saj. Rezultoi se ajo bëri gabime të njëjtë, duke bërë shkarkime pa asnjë analizë, as raport paraprak të performancës së diplomatëve, madje duke i falenderuar ata për punën e tyre vendosi t'i shkarkonte një numër të madh të ambasadorëve politikë, ani pse shumica e tyre ishin brenda mandatit të rregullt të tyre. Kjo përpos që la shije të keqe te vendet pritëse, krijoj edhe një presedan të keq, madje

edhe mund të cilësohet më vonë si shkelje ligjore.

"**Epoka e re**": Gjatë kësaj kohe jo rrallë është kritikuar ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, për qëndrimet që ka mbajtur. A besoni se ka qenë në nivelin e punës së saj kryediplomatja e Kosovës?

Gashi: Sa iu përket deklaratave të saj, ministria Gërvalla jo rrallëherë ia ka huq keq, duke mbajtur qëndrime personale dhe partiake karshi çështjeve që mund të cilësohen të interesit nacional, të cilat ajo do të duhej t'i mbronte. Ka mbajtur qëndrim të butë, me tone pajtuese me homologun serb në fjalimin e saj në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Madje duke mos i njojur faktet historike, e ka paraqitur edhe palën serbe viktivë të gjenocidit. Kjo është e patolerueshme. Më pastaj edhe qëndrimet dhe kualifikimet e saj për realitetin në Kosovë të mbajtur para institucioneve të BE-së shpeshherë nuk janë në përporthje me vlerësimet dhe raportet ndërkombëtare për Kosovën.

"**Epoka e re**": Në rrethanat aktuale, cili duhet të jetë roli i ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës?

Gashi: Padyshim MPJD-ja

duhet të jetë lokomotiva që çon përparrë afirmimin e Kosovës si shtet. Diplomaci konvencionale shumë aktive, diplomaci publike dhe lobing të fuqishëm për të arritur njohje të reja dhe anëtarësimë të reja. Promovim të aseteve ekonomike të Kosovës tek investitorët e huaj. MPJD-ja duhet të jetë edhe një lloj rregulatori për punën e ministrive të tjera për ta rritur eficencën e punës së tyre, në çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e një mjedisi miqësor për investitorët dhe firmat e huaja që duan të investojnë në Kosovë.

"Epoka e re": *Deri më tani kanë ndodhur dy takime në mes të kryeministrit Kurti dhe presidentit Vuçiq në kuadër të dialogut për normalizim të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Si i keni parë këto takime?*

Gashi: Nuk do të doja t'i komentoja shumë sepse ende s'ka asnjë përparim që mund të komentohet. Si duket z. Kurti po e sheh shumë të ndërlidhur këtë proces dhe po heziton të futet në të. Ai po mban qëndrime të forta. Nëse ky është qëllimi për ta bërë Kosovën palë plotësisht të barabartë dhe për ta marrë maksimumin (le të themi

njohjen e shpejtë nga Serbia), atëherë kjo gjë është mirë, por nëse qëllimi është që duke mbajtur qëndrime të forta të bllokojë procesin, kjo edhe mund të ketë kosto për ne. Ende është herët të themi diçka më shumë.

"Epoka e re": *Në të dyja takimet kryeministri Kurti ka bërë propozime konkrete. A kanë qenë të duhura këto propozime?*

Gashi: Propozimet duhen parë, siç thashë, të mira nëse pranohen nga ndërmjetësit, ani pse mund t'i kundërshtojë pala serbe, por nëse këto propozime

nuk pranohen as nga ndërmjetësit (BE-ja dhe ShBA-ja), atëherë do të thotë se ato kërkesa, sado përbajtjesore që mund të jenë, do të shihen si frenuese të procesit të dialogut. Sipas mendimit tim, pala e Kosovës nuk duhet të shpallet frenuese e procesit nga ana e ndërmjetësve ndërkombëtarë, sepse kjo mund të ketë pasoja për ne, siç i kemi parë në një të kaluar jo të largët kur ne u akuzuam se do ta bllokojmë dialogun për demarkacionin dhe për taksën. Nuk jam në mesin e atyre që mendojnë se dialogu ka alternativë dhe se shtetet mike duhet të mos

përzihi në punët tona. Të dyja këto qëndrime i konsideroj gabime kardinale.

"Epoka e re": *Nga këto takime palët nuk janë pajtuar për asgjë rreth dialogut. Në vazhdim të procesit pritni që palët t'i ndryshojnë qëndrimet, apo do të vazhdohet në këtë mënyrë duke mos u pajtuar për asgjë?*

Gashi: Nuk e di sa mund të vazhdojmë kështu, duke ditur se shtetet mike të Kosovës po kërkojnë me ngjurmë levizje në procesin e dialogut. Është herët të prognozojmë çfarë mund të jenë pasojet e këtij pozicionimi intarsigjent të palëve.

Kurti u bënë thirrje qytetarëve të vaksinohen: Rrezikohemi nga përhapja e variantit 'Delta'

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 KORRIK - Kryeministri Albin Kurti ka thënë të premten se kur ka marrë drejtimin e qeverisë, katër muaj më parë, situatën e pandemisë e ka gjetur shumë më të rënduar sesa ajo që e ka lënë më 3 qershor të vitit 2020. "Deri atëherë, sipas të dhënave të IKShPK-së, në total ishin 1 142 raste të infektuar dhe, fatkeqësish, 30 të vdekur. Më 23 mars 2021, rreth tetë muaj pas, të dhënat tregonin për 83 717 raste në total të të infektuarve dhe 1 786 të vdekur nga virusi, kurse vetëm atë ditë kishte 781 raste të reja të infektimit dhe 17 vdekje. Ditën e betimit në Kuvend u zotuam se menaxhimi i pandemisë do të jetë prioritet i qeverisë sonë, për ta ndalur trendin në rritje të infektimeve dhe vdekjeve si pasojë e Covid-19 dhe për të siguruar sa më shpejt vaksinat kundër virusit", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka theksuar se pas përpjekjeve të përbashkëta, sot në Kosovë janë vetëm 126 raste aktive nga 12 808 sosh sa ishin në ditën e parë kur morën drejtimin e qeverisë. "Pandemia është vënë nën kontroll dhe situata është përmirësuar dukshëm, por tani rrezikohemi nga përhapja e variantit 'Delta' të virusit. Përballët i mburoja për secilin prej nesh është vaksina, kurse për të gjithë



së bashku vaksinimi masiv. Vaksinat i kemi siguruar. Ato janë të sigurta. Kosova është vendi i vetëm në rajon që po përdor vetëm vaksinat e aprovuara nga Agjencia Federale e Barnave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Agjencia Evropiane e Barnave, pra 'Pfizer' dhe AstraZeneca'. Tani mund të vaksinohen të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeç dhe mund të zgjedhin vaksinën që dëshirojnë

ta marrin", ka deklaruar Kurti. Kryeministri Kurti u ka bërë thirrje qytetarëve që të vaksinohen kundër Covid-19. "Ju bëj thirrje ta caktoni terminin për vaksinim. Me kujtimin për të dashurit që humbëm nga pandemia, të kujdesemi për veten dhe njerëzit tanë të afërm duke u vaksinuar. Të përgjegjshëm individualisht dhe për njëri-tjetrin, bashkë ia dalim!", ka shkruar Kurti. Instituti Kombëtar i Shëndetit

Publik ka regjistruar 19 raste të reja me Covid-19 në Kosovë nga 2 267 mostra të testuara. Asnjë vdekje nga Covid-19 nuk u regjistrua të premten. Në 24-orëshin paraprak u shëruan shtatë pacientë nga koronavirusi, ndërsa raste aktive mbeten 126. Deri më tani në Kosovë në total janë regjistruar 107 973 raste pozitive. Prej këtyre, 2 265 pacientë kanë vdekur dhe 105 582

janë shëruar. Aktualisht në zhvillim e sipër është fushata e vaksinimit masiv, që do të thotë se të gjithë personat mbi 18 vjeç mund të regjistrohen dhe të imunizohen. Vaksinat që jepen në Kosovë janë: "Pfizer/BioNTech" dhe "AstraZeneca". Qeveria e Kosovës ka thënë se ka prioritet vaksinimin e 60 për qind të qytetarëve deri në fund të këtij viti.

Rahoveci, komuna më transparente në Kosovë



PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - "Aleanca Qytetare për Transparency", konsorcium i OJQ-ve të Kosovës, e udhëhequr nga Institut Demokratik i Kosovës (KDI), ka radhitur komunën e Rahovecit ndër komunat më transparente në Kosovë. Sipas raportit "Transparometrit komunal 2020 & Transparency e

komunave në retrospektive", i publikuar nga KDI-ja, pesë komunat më transparente për vitin 2020 vlerësohet të jenë Rahoveci (93,75 për qind), Drenasi (91,67 për qind), Lipjani (91,67 për qind), Gjakova (89,58 për qind) dhe Mitrovica e Jugut (88,54 për qind). Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë

ndër zotimet e tij ishin transparenca dhe llogaridhënia para qytetarëve. "Këtë çmim ju dedikoj juve, qytetarë të Rahovecit, për bashkëpunimin shembullor për të mirën e përbashkët. Falenderim i veçantë për të gjithë punëtorët e komunës që me dedikimin e tyre në punë e fituan këtë çmim!", ka thënë Latifi.

Hapet Panairi i Librit ‘Fushë-Kosova 2021’, edicioni i parë

FUSHË-KOSOVË, 23 KORRIK (ER) - Të premten në platenë e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Mihal Grameno” në

Fushë-Kosovë është hapur Panairi i Librit “Fushë-Kosova 2021”, edicioni i parë, në të njëjtën kohë është hapur edhe

eksposita “Vullkani” i Republikës” përgatitur nga Agjencja Shtetërore e Arkivave e Kosovës.

Në hapjen e panairit mori pjesë edhe kryetari i komunës së Fushë-Kosovës, Burim Berisha, përfaqësues të tjerë të komunës dhe kryeshefi i Agjencisë Shtetërore i Arkivave të Kosovës, Bedri Zyberaj, i cili bëri hapjen e panairit dhe të ekspositës.

Zyberaj tha se secilit qytet të Kosovës i duhet një panair i tillë i librit, me paraqitje të librave të vjetër, të ri, të rrallë dhe të përdorur, pasi që nëpërmjet lëtyre librave lexuesve u mundësohet të marrin njohuri për botimet e reja, njëkohësisht t'i kujtojnë edhe botimet e librave të viteve '40, '50, '60, '70 e tutje.

Zyberaj foli edhe për rëndësinë e ekspositës “Vullkani” i Republikës” dhe për ngjarjet historike të vitit 1981 që ka paraqitur në njëzet pllakate të madhësisë një metër me 70 centimetra, të cilën ekspositë Agjencja Shtetërore e Kosovës e ka hapur në disa qytete të Kosovës këtë vit.

Ndërkaq kryetari i komunës së Fushë-Kosovës, Burim Berisha, e vlerësoi të rëndësishëm hapjen e këtij panairi dhe bëri me dije se komunës së Fushë-Kosovës i ka munguar panairi i librit dhe, gjithashtu, i mungojnë edhe aktivitetet e tjera kulturore, të cilat, sipas tij, do ta kenë përkrahjen e komunës ndër vite. Gjithashtu, ai tha se eksposita “Vullkani” i Republikës” sjell dëshmi të shumë aktivistëve të devotshëm përrugtimin e tyre deri te shpallja e Republikës së Kosovës.

Panairi i librit organizohet tri ditë me radhë (më 23, 24, 25 korrik), me fillim nga ora 9:00 deri në orën 23:00. Po kaq ditë do të qëndrojë e hapur edhe eksposita.

Në këtë panair janë paraqitur mbi 1 000 tituj të librave të ri dhe mbi 1 000 tituj të librave të vjetër, të rrallë dhe të përdorur nga botues të ndryshëm të Kosovës, të Shqipërisë, të Malit të Zi, të Maqedonisë.

Gjatë ditëve të panairit të librit do të shënohen edhe këto aktivitete:

Punëtori nga punonjësit e



Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës për restaurimin e librit të dëmtuar; Lexime të tregimeve të shkurtra përfëmijë; Promovim të katalogut dhe çeljes së ekspositës “Libri i vjetër, i rrallë dhe i përdorur”; Lexime të poezive dhe të përrallave përfëmijë; Dhurim të librave, nga individë dhe botues, përbibliotekat e shkollave të komunës së Fushë-Kosovës.



Mungesa e parkingjeve mbetet sfidë për personat me aftësi të kufizuara

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Handikosi ka lansuar të premten videojet e vetëdijësuese rrith me dedikuara për

personat me aftësi të kufizuara nëpër hapësira publike. Mungesa e parkingjeve vazhdon të mbetet sfidë për personat me

aftësi të kufizuara, por edhe më sfidë është uzurpimi i atyre që janë nga qytetarë të papërgjegjishëm. Handikosi ka publikuar një film të metrazhit

të shkurtër, i realizuar mbi një ngjarje të vërtetë, i cili pasqyron përditëshmërinë e një personi me aftësi të kufizuar në rrugë.



Prishtina bëhet me mbushës elektrik për vetura në Kosovë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 KORRIK - Kryetari i komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, së bashku me njërin nga aksionarët e "ProCredit Bank", dr. Klaus-Peter Zeitinger, kanë marrë pjesë të premtën në inaugurimin e stacionit të parë për mbushje elektrike për makinat elektrike në Prishtinë. Ky projekt u realizua me financim të "ProCredit Bankë Kosovës" dhe është një ndër projektet e komunës të realizuar në vazhdën e përpjekjeve për mbrojtjen e ambientit. Ahmeti gjatë inaugurimit ka potencuar faktin se ky projekt vjen pas punës njëveçare të Prishtinës, që hyn në grupin e qyteteve të BERZh-it e që janë pjesëmarrëse të Green City Action Plan - GCAP (planit aksional të qyteteve të gjelbra). Në kuadër të këtij plani, Prishtina pritet të realizojë disa projekte të reja. "Do të bëhet rregullimi i energjisë eficience (të ripërtëritshme) në 47 ndërtesa dhe deri në fund të vitit do të nënshkruajmë kontratën për 30



Policia me plan operativ 'Siguria në trafik 2021'

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 KORRIK - Policia e Kosovës, njësitë e trafikut rajonal në Gjilan, në vazhdën e implementimit të planit operativ "Siguria në trafik 2021", të premtën në orët e parades kanë vazhduar kontrollot e shtuara të veturave dhe mjeteve transportuese me qëllim të preventimit dhe parandalimin e aksidenteve në trafik, në rrugën magjistrale Gjilan - Ferizaj, punë kjo që do të vazhdojë edhe në ditët të tij. Në kuadër të këtij plani bashkë me oficerët e trafikut rajonal kanë asistuar edhe njësitë e specializuara me

kontolle përmes dronit.

Vëzhgimi i rrjedhës së komunikacionit dhe qarkullimi i veturave në rrugët nationale përmes dronit po ndihmon në identifikimin e kundërvajtësve që bëjnë shkelje ligjore gjatë vozitjes, kryesisht "tejkalimi në vijë të plotë, tejkalimi i kolonës së disa veturave, tejkalimi në udhëkryqë apo në vende me dukshmëri të zvogëluar". "Efekti i punës përmes kontrolleve me dron, qartë po duket se është i dobishëm dhe ndjeshëm ka ndikuar që të kemi më pak aksidente në rrugët nationale. Vlen të ceket se gjatë njëzet e katër orëve të fundit janë shqiptuar gjithsej nëntëdhjetë e tri (93) gjoba

të ndryshme, përfshirë edhe konfiskimin e pesë patentëshoferëve në raste të kundërvajtjeve të ndryshme si 'tejkalim në vijë të plotë, tejkalim i shpejtësisë së kufizuar në bazë të shenjave të trafikut' etj", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Po në këtë njoftim theksohet se "Policia e Kosovës, njësitë e trafikut rajonal në Gjilan, në vazdimësi kërkojnë nga vozitësit dhe gjithë pjesëmarrësit në komunikacion që të kenë kujdes maksimal dhe t'i respektojnë rregullat dhe shenjat e komunikacionit gjatë qarkullimit në rrugë sepse zero tolerancë do të aplikohet ndaj seçilit pa dallim që bie në kundërshtim me ligjin".

MASHTI po i bën përgatitjet që viti i ri shkollor të fillojë me kohë

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Zëvendësministri i Arsimit, i Shkencës, i Teknologjisë dhe i Inovacionit, Dukagjin Pupovci, ka bërë me dije të premtën, në një konferencë për media, se kjo ministri është duke i bërë përgatitjet që viti i ri shkollor të fillojë me kohë. Ai ka përmendur disa nga aktivitetet që janë kryer dhe ato që janë në proces përnjë fillim të mbarë të vitit shkollor, ndër të tjera, edhe hartimin e "Kalendarit të vitit shkollor 2021/2022" i cili aktualisht është

në konsultim.

Pupovci ka thënë se tashmë ka përfunduar afati i parë i regjistrimit të nxënësve në klasën e dhjetë, duke bërë me dije se afati i dytë është më 23 gusht. Duke folur për programet mësimore dhe tekstet shkollore, Pupovci ka theksuar se në këtë vit shkollor do të ketë tekste alternative përklasat 1, 2, 6 dhe 7, ndërsa ka thënë se ministria ka përgatitur të gjitha procedurat përfurnizimin e nxënësve me tekste mësimore për vitin

shkollor 2021/2022.

Sa iu përket dorëshkrimeve për tekstet e reja shkollore për klasat 3, 8, 12, zëvendësministri Pupovci ka theksuar se ato janë në proces të rishikimit nga autorët pas vlerësimit të parë nga recensentët. Pupovci ka folur edhe përvaksinimin e mësimdhënësve kundër Covid-19. Ai ka thënë se presim që gjatë pushimeve të verës të gjithë mësimdhënësit të vaksinohen dhe ta fillojnë punën me shëndet të plotë.



Mbahet takimi për procesin e përgatitjes së programit për reforma ekonomike 2022-2024

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 KORRIK - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, në cilësinë e koordinatorit nacional, ka hapur takimin për lansimin e procesit të përgatitjes së programit për reforma ekonomike 2022-2024. Gjatë takimit ministri Murati ka thënë se qeveria është e përkushtuar ta ndjekë agjendën e integrimit evropian, me theks të veçantë zbatimin e prioriteteve të reformave strukturore. Ai, po ashtu, u ka bërë thirrje ministrave përgjegjës ta vendosin këtë proces në prioritetet e tyre kryesore.

Programi për reforma në ekonomi është dokument që dorëzohet te Komisioni Evropian më 31 janar të çdo viti dhe përfaqëson nivelin më të lartë të angazhimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë në çështjet socio-ekonomike. Në

këtë kontekst, zbatimi i reformave të identikuara në programin për reforma ekonomike dhe i udhëzimeve të politikave të miratuara bashkërisht me shtetet anëtare të BE-së është thelbësor jo vetëm për ta përmirësuar konkurrencën, por edhe për ta nxitur krijimin e vendeve të punës, për ta lehtësuar përfshirjen sociale, si dhe për t'i përbushur kriteret ekonomike në procesin e anëtarësimit.

Ky program është një nga mekanizmat e Komisionit Evropian për monitorimin e paraqitjes së Republikës së Kosovës si kandidat potencial në proces të paraanëtarësimit, të transformimit të ekonomisë dhe arritjes së standardeve të tregut evropian, i cili është edhe udhëzues i mirë për ndërlidhjen e politikave me buxhetin e vendit në aspektin e planifikimit strategik shumëvjeçar.



Murati nënshkruan marrëveshje prej 15 milionë eurosh me Bankën Botërore



PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, dhe drejtoresha për Ballkanin Perëndimor e Bankës Botërore, Linda Van Gelder, pas negocimit të suksesë, kanë nënshkruar marrëveshjen e financimit "Projekti emergjent i Kosovës për Covid-19 - financimi shtesë".

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se kjo marrëveshje kap vlerën totale prej 15 milionë eurosh, marrëveshje nga e cila në muajin e kaluar kishe përfituar 46 milionë euro për menaxhimin e pandemisë. "Qëllimi kryesor i marrëveshjes mbetet vazhdimësia e përgjigjes

ndaj pandemisë përmes financimit për ta mundësuar parandalimin, detektimin dhe reagimin ndaj Covid-19 si dhe për t'i ngritur kapacitetet e duhura në sistemet kombëtare të shëndetit publik. Kjo marrëveshje kap vlerën totale prej 15 milionë eurosh dhe vjen si vazhdimësi e marrëveshjes bazë, të nënshkruar më 29 qershor 2020 me Bankën Botërore, e cila veçse kishte siguruar 46 milionë euro për menaxhimin dhe reagimin emergjent ndaj pandemisë", thuhet në komunikatën e kësaj ministrie. Projekti do ta mundësojë prokurimin e vaksinave kundër Covid-19, vaksinimin efektiv të

popullatës, përmirësimin e sistemit të imunizimit, zhvillimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave mjekësore, prokurimin emergjent të barnave esenciale për trajtim të Covid-19 dhe të ngjashmeve si dhe zhvillimin e strategjisë shëndetësore, mes të tjera. Rikujtojmë se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve po ashtu ka përcaktuar masat për Ringjallje Ekonomike të vendit të cilat synojnë t'i adresojnë vështirësitë e shkaktuara nga pandemia Covid-19, ndër të tjera, duke stabilizuar aktivitetin ekonomik në Republikën e Kosovës.

Mërgata, motor i zhvillimit ekonomik të Kosovës

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - "Pa mërgatën nuk do të kishte pasur lëvizje dhe mërgata jonë është gjithnjë në lëvizje", ka thënë kryeministri dhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në fjalën e tij hapëse në takimin me bashkatdhatarë. Në parkun e qytetit në Prishtinë të rregulluar përngjarjen "Lëvizja me mërgatën" që mbahet çdo vit, shumë mërgimtarë kishin ardhur të njiheshin e të bashkëbisedonin me deputetët, ministrat dhe aktivistët e LV-së.

Kurti në këtë takim ka folur për të arriturat e qeverisjes që ai drejtton, ku veçoi luftimin e krimit dhe

korrupsionit. Duke iu referuar politikës së emetimit të bonove për diasporën që vetëm në ditën e parë mblodhi një investim të diasporës prej 1 milion eurosh, Kurti ka thënë se mërgata, përvëçse motor për zhvillimin e jetës së qëndrueshme në vendin tonë, tanj po bëhet edhe motor i zhvillimit ekonomik të saj. Kurti në këtë takim ka folur edhe për rendësinë që ka regjistrimi dhe pjesëmarja e mërgatës edhe në zgjedhjet lokale që po afrojnë. "Bashkë është e mundshme dhe bashkë si gjithnjë, si përherë, ia dalim t'i jetësojmë ndryshimet përtë cilat kemi nevojë e të cilat i duhen vendit", ka deklaruar Kurti.





INTERVISTË ME POETIN DHE PROFESORIN E LETËRSISË SHQIPE, SALI BASHOTA

Vendlindja është ngrohtësia e veçantë emocionale

Bisedoi: Berat ARMAGEDONI

Bashotët, fqinjët tuaj, i keni të pranishëm në disa poezi. Përpinqeni të komunikoni me ta nëpërmjet vargjeve. Sa shpesh shkoni në vendlindje, te fqinjët dhe tek e éma, meqë ka vite që jetoni në Prishtinë?

Kujtimet e dashura dhe të paharruara për Nënën i kam rrëfyer në fillim të intervistës, të cilat sikur më ngajnjë si ligjérata që kanë një art të veçantë.

Vendlindja është ngrohtësia e veçantë emocionale. Me farefisin tim jam i lidhur shumë shpirtërisht. Çdo kujtim imi i fëmijërisë strehën më të dashur e ka në ambientin e vendlin-djes. Kam provuar gjithmonë të kem respekt për më të dashurit e mi.

Emri im është trashëgim nga gjyshi. Thonë se gjyshi im, i cili kishte vdekur tri vjet pa lindur unë, ishte njeri me virtute të larta. Ishte bamirës dhe shquhej

për guximin dhe përvendo-smërinë e tij. Kam dëgjuar shumë rrëfime interesante për jetën dhe të bëmat e tij, sidomos për parimet, mençurinë dhe humorin e tij. Rrëfimet e shumta për gjyshin më kanë frymëzuar një kohë të gjatë në rrugët e jetës, ndërsa disa ngjarje të dëgjuara i kam paraqitur edhe në poezinë time.

Farefisin tim, pra Bashotët, i kam të pranishëm në shumë poezi të mia, gjithnjë si një shpërthim i rrëmbyeshëm i ndje-njave të mia në shenjë respekti dhe mirënjohjeje. Pa dyshim, kjo ndjenjë dashurie më ka dhënë vetëbesim dhe kurajë për t'i fuqizuar idetë e mia krijuese në veprën time letrare, duke e ditur faktin se historia e Bashotëve mbartë në vete krenari kombëtarë.

Gjatë gjashtë dekadave jetë keni lexuar gjithçka, keni parë lloj-lloj personazhesh dhe lloj-lloj personash. Unë nuk dua të jeni më ndryshe se kështu si jeni,

po ju, si cili personazh i letërsisë shqiptare a botërore a si cili shkrimitar do të donit të ishit?

Në çdo rrethanë apo situatë më së miri është të jesh vetvetja. A thua e është kjo jeta ideale? Pse mos të jesh edhe si Tjetri?

Gjithmonë më ka pëlqyer koncepti apo pikëvështrimi përdallimin e gjërvave, sendeve, fenomeneve, pastaj krasimi i tyre. Ndër të pëlqyerit e mi janë: Dante, Lasgushi dhe Borhesi.

Do të doja të isha si Dante Aligeri por, përfat, i paskam shpëtuar vdekjes në moshën e tij (Dante jetoi vetëm 56 vjet), pastaj të isha edhe si Lasgush Poradeci (sipas vitit së ikjes të tij në amshim, mua më kanë mbetur edhe 26 vjet), por edhe si Jorge Luis Borgesi (lindi po atë vit kur lindi Lasgushi, por iku në amshim një vit më herët).

Është e çuditshme se për shkrimitarët që do të doja të isha si ata, nuk kam shkruar asnjë ese apo studim letrar, përvëçse nga një poezi kushtuar Lasgushit

(Poezi e pambaruar te varri i Lasgush Poradecit) dhe Borhesit (Borhesi i verbuar).

Nga Dante më pëlqen krijimi i kuptimit simbolik për jetën, përdashurinë dhe përvdekjen, apo numri i trinisë: Ferri, Purgatori dhe Parajsia. Në këtë kontekst, estetika e receptimit do të shëmbellente si shenjë dhe si strukturë, pikërisht me imazhin simbolik, nga kujtesa e leximit kur Dante vishej me kostume të kaltra, duke e imaginuar Batriçen me kostume të kuqe. Kësaj radhe mund të jetë analogjia e poezisë me pikturën, pikërisht në rikthimin e imazheve.

Po kështu mund të flas me admirim për Lasgushin, njërin nga poetët më të mençur të poezisë shqipe, i cili mund të jetë referencë për të gjithë poetët. Do të dëshiroja t'i ngaj vitëm imaginatës së tij ndaj ligjërimit të dashurisë. Kur e kam lexuar studimin e Kutelit për poezinë e Lasgushit, kam menduar me vetveten: a do të më ndodh

ndonjëherë një dashuri e tillë zbuluese e leximit, midis poetit dhe kritikut.

Do të doja të isha si Borhesi përtak shijuar imaginatën time në jetë, por edhe në vepra, duke ligjëruar para Pasqyrës së Jetës Njerëzore. Po ashtu, përtiu bërë lutje poetëve (në lindje dhe në perëndim të diellit) që të shkruajnë vetëm për dashurinë njerëzore.

Është ndjenjë e mirë kur thua do të doja të isha... sepse, pos një aventurë shpirtërore, do të ishte një fat i mrekullueshëm, së paku përtë éndërruar përtë hyrë në një botë imaginare dhe përtë shkuan edhe pak më tej...

(Intervistën e plotë, prej 62-pyjetjesh dhe përgjigjesh, do të mund ta lexoni në librin 'Dialog me Sali Bashotën' që do të botohet këtë vit).

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademja". Vjon në numrat e ardhshëm të gazetës. © "Armagedoni").



ORHAN PAMUK

VALIXHJA E BABAIT TIM

Ligjérata e Nobelit, 7 dhjetor 2006

Dy vjet para se të vdiste, babai im më dha një valixhe të vogël të mbushur me shkrimet e veta, me dorëshkrime dhe me shënime. Me qëndrimin e tij të rëndomtë hokatar dhe shpotitës, ai më tha se do të dëshironte që unë t'i lexoja të tèrat pasi ai të kishte shkuar, me ç'gjë ai donte të thoshte pasi të kishte vdekur.

'Vetëm ua hedh një shikim', tha ai paksa i shqetësuar. 'Shih nëse gjen diçka që mund të të duhet. Ndoshta, pasi të kem shkuar, do të mund të bësh një përgjedhje dhe ta botosh. Po rrinim në studion time të rrerhuar nga librat. Babai po kërkonte një skutë ku do ta vente valixhen, duke bredhur poshtë e lart, si një njeri që donte të hiqte nga vetja një barrë të rëndë. Më në fund, ai e vendosi atë pa zhurmë në një kënd ku nuk pengonte. Ishte një çast turpërimi që asnjëri prej nesh nuk do ta harronte, por porsa kaloi dhe porsa ne u kthyem në rolet tona të zakonshme, lehtësia e jetës, shakatë tona,

shpotitjet na u kthyen prapë dhe ne u ndjemë të relaksuar. Folëm siç flisnim gjithnjë, mbi imtësitë e jetës dhe hallet c pafundme politike të Turqisë dhe për projektet kryesish të dështuara të biznesit të babait, pa ndier ndonjë pikëllim të veçantë.

Më kujtohet se pasi babai u largua, kalova disa ditë duke ecur poshtë e lart pranë valixhes pa e prekur asnjëherë. Tashmë isha mësuar me këtë valixhe të vogël, të zezë prej lëkure dhe me drynin dhe skajet e tij të rrumbullakëta. Babai e merrte atë me vete në udhëtime të shkurtra dhe nganjëherë edhe në punë për të mbajtur në të dokumente. Më kujtohet se kur isha fëmijë, dhe kur babai kthehej nga ndonjë udhëtim, unë hapja valixhen e tij të vogël dhe zhbiroja nëpër gjërat e tij duke ndier aromën e kolonjës dhe të vendeve të huaja. Kjo valixhe ishte një mik i njohur, një përkujtues i fuqishëm i fëmijërisë sime, i së kaluarës sime, por tani as që mund ta prekja. Po pse? Pa mëdyshje, kjo

ishte për shkak të peshës misterioze të përbajtjes së saj.

Tani do të flas për kuptimin e kësaj peshe. Kjo është ajo që dikush krijon kur mbyllët në dhomë, ulet pranë tavolinës dhe tërhiqet në një kënd për t'i shprehur mendimet e tij - ky është kuptimi i letërsisë.

Kur preka valixhen e babait ende nuk merri forcë ta hapja, por ama e dija se çfarë kishte brenda atyre shënimeve. E kisha parë babanë duke shkruar disa prej tyre. Kjo nuk ishte hera e parë që kisha dëgjuar për peshën e rëndë brenda asaj valixheje. Babai kishte një bibliotekë të pasur; si i ri, nga fundi i viteve 1940, ai kishte dashur të bëhej poet i Stambollit dhe kishte përkthyer Valerin në turqisht, por ai nuk kishte dashur të conte atë lloj jete që sillte të shkruarit e poezisë në një vend të varfër dhe me pak lexues. Babai i babait tim - gjyshi im - kishte qenë biznesmen i pasur. Babai im kishte pasur jetë të rehatshme si fëmijë dhe si i ri ai nuk ishte i gatshëm të kalonte

nëpër krajata për hir të letërsisë dhe të shkrimit. Ai e donte jetën me të gjitha bukuritë e saj - këtë e kuptoja.

Gjëja e parë që më mbante larg përbajtjes së valixhes së babait, s'do mend, ishte droja se ajo që do të lexoja mund të mos më pëlqente. Pasi që im atë e dinte këtë, ai ishte përkuj-desur që të shtirej sikur nuk e merrte me gjithë mend valixhen. Pas punës 25-vjeçare si shkrimitar, e kisha vështirë ta shihja këtë. Por, unë as që dëshiroja të zemërohesha me tim atë pse kishte dështuar ta merrte me shumë seriozitet letërsinë... Frika ime e vërtetë, gjëja thelbësore që unë nuk doja ta kuptoja apo ta zbuloj, ishte mundësia që babai mund të ishte shkrimitar i mirë. Unë nuk mund ta hapja valixhen e babait sepse kisha frikë nga kjo. Edhe më keq, as që mund t'ia pranoja këtë vetes hapur. Po të ishte e vërtetë dhe sikur nga valixhja e babait të dilte një letërsi e madhe, do të më duhej të pranoja se brenda babait tim

kishte ekzistuar një njeri krejtësisht tjetër. Kjo ishte një mundësi e frikshme. Sepse, madje edhe në moshën time të shtyrë dëshiroja që babai im të ishte vetëm babai im - dhe jo shkrimitar.

Shkrimitar është ai që kalon vitet duke u përpjekur me durim ta zbulojë qenien e dytë brenda tij dhe botën që e bën atë ai që është: kur flas për shkrimin, ajo që më bie së pari në mend është romani, poezia, apo tradita letrare, është një person i cili mbylli veten në dhomë, ulet pranë tavolinës dhe, i vëtmuar, i kthehet brendisë dhe brenda hijeve të saj ndërtón një botë të re me fjalë. Ky burrë - apo kjo grua - mund të përdorë një makinë shkrimi, mund të përfitojë nga lehtësia e një kompjuteri, apo të shkruajë me një penë në letër, siç kam bërë unë për tridhjetë vjet. Duke shkruar ai mund të pijë çaj apo kafe, apo të ndezë një cigare. Herë pas herë ai mund të ngrihet nga tavolina e punës për t'u hedhur një shikim nga dritarja

fëmijëve që lozin në rrugë dhe, po të jetë me fat, drurëve dhe peizazheve, apo mund ta tret shikimin mbi një mur të errët. Ai mund të shkruajë poezi, drama, apo romane, siç bëj unë. Të gjitha këto ndryshime vijnë pas detyrës vendimtare të të ulurit pranë tavolinës së punës dhe kredhjes durimplotë përbrenda vetes. Të shkruash do të thotë që të shndërrosh këtë kredhje të brendshme në fjalë, ta studiosh botën nëpër të cilën ai kalon, kur kridhet në vjetvete dhe ta bësh këtë me durim, me këmbëngulësi dhe me gjëzim. Kur rri ulur pranë tavolinës sime, me ditë, me muaj, me vite, duke hedhur fjalë të reja, njëren pas tjetrës, në faqe të zbrazëta, ndihem sikur po krijoj një botë të re, sikur po sjell në jetë atë personin tjetër brenda meje, ashtu siç ndërton dikush një urë, apo një pallat, gur më gur. Gurët që përdorim ne shkrimitarët, janë fjalët. Duke i mbajtur ato në duar, duke ndier mënyrat se si secila prej tyre lidhet me të tjerat, duke i parë nganjëherë nga larg, nganjëherë pothuajse në përfqafim të gishtërinje dhe majat e penës, duke i peshuar ato, duke i lëvizur sa andej-këtej, vit pas viti, me durim dhe shpresë, ne krijojmë botë të reja.

Fshehtësia e shkrimitarit nuk është frymëzimi - sepse nuk është asnjëherë e qartë se prej nga vjen ai, por fshehtësia e tij është këmbëngulësia, durimi i tij. Ajo thënie e bukur turke - të hapësh një pus me gjilpërë - më duket të jetë thënë duke pasur parasysh shkrimitarin. Në rrëfimet e vjetra më pëlqen durimi i Ferhatit, i cili rrëmih një mal të tërë për dashurinë e tij dhe unë e kuptoj edhe këtë. Në romanin tim, Quhem i kuqi, kur shkrova për miniaturistët persianë, që kishin vizatuar të njëtin kalë me të njëtin pasion për shumë vite me radhë, duke mbajtur në mend çdo vijë, që të mund ta rikrijonin kalin e bukur edhe me sy të myllur, e dija se përfundimisht zuri të më fliste për atë periudhë të jetës së vet. Ai fliste për ato vite edhe kur isha fëmijë, ndonëse nuk zinte në gojë dobësitet e tij, èndrrat e tij për t'u bëre shkrimitar apo çështjet e identitetit që e kishin munduar në dhomën e tij të hotelit.

Po t'i kthehem mendimit mbi librat të cilave u kam kushtuar tërë jetën, më së shumti befasohem nga ato çaste kur e ndieja sikur ato fjalë, èndrra dhe faqe, që më kishin sjellë dalldisjen më të madhe të lumturisë, nuk vinin nga imaginata ime - se një forcë tjetër i kishte gjetur ato dhe m'ki kishte dhënë mua me zemërgjerësi.

Kisha frikë ta hapja valixhen e babait dhe t'i lexoja shënimet e tij ngaqë e dija se ai nuk do t'i duronte dot vështirësitë të cilat unë i kisha duruar, se nuk ishte vëtmia ajo që ai dëshiron, por të qenit mes miqsh, mes tur mash, sallonesh, shakash dhe shoqërish. Por, më vonë mendimet e mia morën një kthesë tjeter. Këto mendime, këtë èndrra të dëbimit dhe durimit, ishin paragjykimet që kisha nxjerrë nga jeta dhe përvaja ime si shkrimitar. Kishte shumë shkrimitarë të shkëlqyer që shkruanin të rrethuar nga turma dhe jeta familjare për shkëlqimin e shoqërisë dhe përlafosjet gaztore. Përpos kësaj, im atë, kur ishim të rinj, i lodhur nga monotonia e jetës familjare, na la duke ikur vetë në Paris ku, si shumë shkrimitarë, rrinte në dhomën e hotelit duke mbushur fletoret. E dija, gjithashtu, se pikërisht disa prej këtyre fletoreve me shëнимë ishin në valixhen e tij, sepse në vitet para se të ma sillte atë, babai përfundimisht zuri të më fliste për atë periudhë të jetës së vet. Ai fliste për ato vite edhe kur isha fëmijë, ndonëse nuk zinte në botë, në Lindje apo në Perëndim - janë të shkëputur nga shoqëria dhe që myllen me librat e tyre nëpër dhoma. Pika e nisjes e letërsisë së vërtetë është njeriu që rri myllur në dhomën e tij me librat e veta. Por, porsa ta kemi kyçur veten larg të tjerëve, do të zbulojmë shpejt se nuk jemi edhe aq të vëtmuar sa kemi menduar. Ne jemi në shoqërinë e fjalëve të atyre që kanë qenë para nesh, të tregimeve të njerëzve të tjerë, të librave të njerëzve të tjerë, të asaj që ne e quajmë traditë. Besoj se letërsia është grumbulli më i vlefshëm që ka mbledhur njerëzimi në kërkimin e tij për ta kuptuar vvetveten.

Shoqëritë, fiset dhe popujt bëhen më të zgjuar, më të pasur dhe më të përparuar kur u kushtojnë vëmendje fjalëve të trazuara të autorëve të tyre dhe, siç e dimë të gjithë, djegia e librave dhe denigrimi i shkrimitarëve janë sinjale se kohëra të zeza dhe të paparashikueshme po na vijnë. Por letërsia nuk është asnjëherë vetëm interesim kombëtar. Shkrimitari që myll veten e tij në një dhomë dhe që së pari merr udhën brenda vetes së tij, do të zbulojë, me kalimin e viteve, rregullin e përfjetshëm të letërsisë: ai duhet ta ketë mjeshtërinë artistike për t'i rrëfyer tregimet e veta sikur të

apo revistën në dorë dhe kotej, e humbte veten për një kohë të gjatë në mendime. Kur shihja fytyrën e tij, një shprehje aq të ndryshme nga ajo që kishte gjatë shakave, gjërgatjeve dhe grindjeve të jetës fami-ljare, kur shihja shenjat e para të një përqendrimi të brendshëm, e shihja, sidomos në vitet e rinisë sime të hershme, me ankth se ai nuk ishte i kënaqur. Tani, kaq vjet më vonë, e di se ajo pakënaqësi është tipari kryesor që e bën dikë shkrimitar. Që të bëhesh shkrimitar, durimi dhe puna e madhe nuk mjaftojnë: ne duhet që së pari të detyrohem i t'u ikim turmave, shoqërisë, gjëra të zakonshme, ditës së përditshme dhe që të myllemi në dhomë. Duam që të kemi durim dhe shpresë, që të mund të krijojmë një botë të thellë në shkrimin tonë. Por dëshira për t'u myllur në një dhomë është ajo që na shtyn në veprim. Pararendësi i këtij lloji të shkrimitarit të pavarrur - i cili lexon librat e veta sipas dëshirës së zemrës së tij dhe i cili, duke dëgjuar vetëm zërin e ndërgjegjës së vet, që zihet me fjalët e të tjerëve, i cili, duke hyrë në bisedë me librat e tij, zhvillon mendimet e veta dhe botën e vet është, pa dyshim, Montanji, në ditët e hershme të letërsisë moderne. Montanji ishte një shkrimitar të cilit i kthehej shpesh im atë, një shkrimitar që ai ma rekondonte. Do të dëshiroja ta shihja veten se i përkas asaj tradite shkrimitarësh, të cilët - ngado që lexohen në botë, në Lindje apo në Perëndim - janë të shkëputur nga shoqëria dhe që myllen me librat e tyre nëpër dhoma. Pika e nisjes e letërsisë së vërtetë është njeriu që rri myllur në dhomën e tij me librat e veta. Por, porsa ta kemi kyçur veten larg të tjerëve, do të zbulojmë shpejt se nuk jemi edhe aq të vëtmuar sa kemi menduar. Ne jemi në shoqërinë e fjalëve të atyre që kanë qenë para nesh, të tregimeve të njerëzve të tjerë, të librave të njerëzve të tjerë, të asaj që ne e quajmë traditë. Besoj se letërsia është grumbulli më i vlefshëm që ka mbledhur njerëzimi në kërkimin e tij për ta kuptuar vvetveten.

Shoqëritë, fiset dhe popujt bëhen më të zgjuar, më të pasur dhe më të përparuar kur u kushtojnë vëmendje fjalëve të trazuara të autorëve të tyre dhe, siç e dimë të gjithë, djegia e librave dhe denigrimi i shkrimitarëve janë sinjale se kohëra të zeza dhe të paparashikueshme po na vijnë. Por letërsia nuk është asnjëherë vetëm interesim kombëtar. Shkrimitari që myll veten e tij në një dhomë dhe që së pari merr udhën brenda vetes së tij, do të zbulojë, me kalimin e viteve, rregullin e përfjetshëm të letërsisë: ai duhet ta ketë mjeshtërinë artistike për t'i rrëfyer tregimet e veta sikur të

ishin tregime të dikujt tjeter, kurse tregimet e të tjerëve t'i rrëfejë sikur të ishin të tijat, sepse kjo është letërsia. Por, së pari, duhet të udhëtojmë nëpër tregimet dhe librat e njerëzve të tjeter.

Babai im kishte një bibliotekë të pasur, me 1 500 vëllime, më shumë se mjaft për një shkrimitar. Deri kur mbusha 22 vjet unë, mbaze, nuk i kisha lexuar të gjitha, por e njihja se cilësinë, e dija se cilat ishin të rendësishme, cilat ishin klasike, cilat përbën pjesë të arsimimit, cilat ishin shkrime mbi historinë lokale që harroheshin, por që ishin dëfryese dhe cilëve autorëve frëngë babai im u kishte dhënë nota të larta. Nganjëherë e shikoja këtë bibliotekë nga largësia dhe e merrja me mend se si një ditë në një shtëpi tjeter do të kisha bibliotekën time, një bibliotekë edhe më të mirë - një botë që kisha ngritur vetë. Kur shikoja bibliotekën e babait nga larg, më dukej sikur ishte një panoramë e vogël e botës së vërtetë. Por kjo ishte një botë e parë nga këndi ynë. Nga Stambollit. Biblioteka ishte dëshmi e kësaj. Babai im e kishte krijuar bibliotekën e tij nga udhëtimet e tij jashtë, të shumtën me libra nga Parisi e Amerika, por edhe nga libra që i kishte blerë nëpër dyqane që shisnin libra në gjuhë të huaja, gjatë viteve '40 e '50, si dhe nga shitës të vjetër dhe të rinj librash në Stamboll, të cilët unë, po ashtu, i njihja. Bota ime është një përzierje e vendit - kombëtares - dhe Perëndimit. Gjatë viteve '70, edhe unë fillova, nisi me ambicie, ta krijoja bibliotekën time. Ende s'kisha vendosur plotësisht të bëhesha shkrimitar, siç e kam përmendur te Stambollit, kisha ardhur në përfundim se nuk mund të bëhesha piktor, por që nuk isha i sigurt se cili do të ishte shtegu i jetës sime që do të ndiqja. Kisha përbrenda njëfarë lloje kureshtje të pandalshme, një dëshirë shprese për të lexuar dhe mësuar, por në të njëjtën kohë ndihesha sikur jetës sime diçka i mungonte, se unë nuk isha në gjendje të jetoja si të tjerët. Një pjesë e kësaj ndjenje lidhej me atë që ndieja kur sodisja bibliotekën e babait tim - jeta larg nga qendra e gjëra, ngaqë të gjithë ne që jetonim në Stamboll në atë kohë, ishim mësuar të mendonim dhe kishim ndjenjën se jetonim në provinca. Kishte dhe një arsyet që më shqetëson dhe më bënte të ndihesha i mangët ngaqë gjithashtu e dija fare mirë se jetoja në një vend që shfaqtë pak interesim për artistët e vet - qoftë piktorë apo shkrimitarë - dhe kjo nuk u jepte atyre shpresë. Në të '70-tat, kur merrja paratë që më jepte babai dhe pangopshëm blija libra të vyshkura, të pluhurosura, me fletë të caraveshura, nga shitës të

librave në Stamboll, prekesha sa nga gjendja e mjerueshme e librarive të dorës së dytë me zhübrosjen dëshpëruese te shitësve të librave që ekspozonin mallin e tyre buzë rrugëve, në oborret e xhamive dhe në skutat e mureve të shkërmorë - sa dhe nga librat e tyre.

Sa i përket vendit tim në botë - në jetë, si në letërsi, ndjenja ime e thjeshtë ishte se unë 'nuk isha në qendër'. Në qendrën e botës kishte një jetë më të pasur dhe më gjallëruese nga ajo jona dhe me tërë Stambollin e me tërë Turqinë, unë isha jashtë saj: Sot mendoj se ndaj këtë ndjenjë me shumicën e njerëzve në botë. Në të njëjtën mënyrë kishte një letërsi botërore dhe qendra e saj, po ashtu, ishte larg nga unë. Në të vërtetë, ajo që më sillej ndërmend ishte letërsia perëndimore, jo botërore dhe ne, turqit, ishim jashtë kësaj. Biblioteka e babait tim ishte dëshmi e kësaj. Nga njëra anë ishin librat e Stambollit - letërsia jonë, bota jonë lokale, në të gjitha detajet e saj të dashura - dhe në anën tjetër ishin librat nga ajo botë tjetër, perëndimore, me të cilën bota jonë s'kishte ngashmëri, mungesa e ngashmërisë e së cilës na mbillte dhembje dhe shpresë. Të shkruaje, të lexoje, ishte sikur të braktisje një botë për të gjetur ngushëllim në tjetërsinë e botës tjetër, të çuditshme dhe të mrekullueshme. Ndihesha sikur babai im të kishte lexuar romane për të ikur nga jeta e tij dhe për t'u arratisur në Perëndim - mu ashtu siç do të bëja unë më vonë. Apo, më dukej sikur librat atëbotë ishin gjëra që ne i merrnim për të ikur nga kultura jonë, që e konsideronim me aq shumë mangësi. Nuk ishte vetëm përmes leximit që ne iknim nga Stambollit për të udhëtaruar në Perëndim - kjo bëhej edhe përmes shkrimit. Për t'i mbushur fletoret e tij, babai kishte ikur në Paris, ishte myllur në dhomën e tij dhe ishte kthyer bashkë me shkrimet e tij në Turqi. Sa herë hedhja shtë mbi valixhen e babait tim, më dukej sikur kjo më sillte shqetësim. Pas punës në një dhomë për 25 vjet me radhë, për të mbijetuar si shkrimitar në Turqi, ndihem i hidhëruar kur shoh babanë tim t'i fshehë mendimet e tij të thella brenda valixhes së tij, të shtiret sikur të shkruar ishte punë që dukej bërë në fshehtësi, larg syve të shoqërisë, shtetit dhe njerëzve. Mbështetje kjo ka qenë arsyet që më shqetëson dhe më bënte të ndihesha i mangët ngaqë gjithashtu e dija fare mirë se jetoja në një vend që shfaqtë pak interesim për artistët e vet - qoftë piktorë apo shkrimitarë - dhe kjo nuk u jepte atyre shpresë. Në të '70-tat, kur merrja paratë që më jepte babai dhe pangopshëm blija libra të vyshkura, të pluhurosura, me fletë të caraveshura, nga shitës të



me miqtë dhe të dashurit e tij. Por, një pjesë imja e dinte se unë mund të thosha, gjithashu, se nuk isha aq 'i zemëruar' sa isha 'xheloz', se fjalë e dytë ishte më e saktë dhe se, po ashtu, më krijuante një bezdi. Kjo ndodhë kur pyesja veten me zërin tim zakonisht përcmues dhe të zemëruar: 'Ç'është lumturia?'. Ç'lumturi ishte ajo të mendosh se bën jetë të thellë në atë dhomë të vëtmuar? Apo, ishte, vallë, lumturi të bëje një jetë të rehatshme në shoqëri, duke besuar në të njëjtat gjëra si dhe njerëzit e tjerë, apo të aktroje sikur ishe i lumtur? Ç'është lumturia, apo moslumturia, të kaloste jetën duke shkruar në fshehtësi, ndërkohe që shtiresë se je në harmoni me të gjithë përreth një njeriu. Po, këto ishin pyetje tepër keqdashëse. Nga e kisha marrë, vallë, idenë se masa e jetës së mirë ishte lumturia? Njerëzit, letrat, të gjithë silleshin sikur masa më e rëndësishme e jetës të ishte lumturia. A nuk sugjerononte edhe kjo se do t'ia vidente të zbulojë nëse e kundërtë ishte e vërtetë? Pas të gjithave, babai im kishte ikur nga familja e tij sa e sa herë - sa mirë e njihja dhe sa me të drejtë do të mund të thosha se e kuptoja bezdinë e tij.

Pra, kjo ishte ajo që më cyste kur hapa për herë të parë valixhen e babait. A kishte im atë ndonjë fshehtësi, ndonjë mungesë lumturie në jetën e tij, për të cilën nuk dija gjë, diçka që ai mund ta duronte vetëm duke e hedhur në letër? Porsa hapa

valixhen m'u kujtua kundërmimi i udhëtimeve, njoħa disa fletore shēnimesh dhe pashë se im atë m'i kishte treguar ato para shumë vitesh, por pa u thelluar në to për një kohë më të gjatë. Shumica e fletoreve me shēnime që tanë kisha në dorë, ai i kishte mbushur kur kishte vajtur në Paris si i ri. Kurse unë, si shumë shkrimitarë të tjerë që i admiroja - shkrimitarë, biografitë e të cilëve i kisha lexuar - doja të dija se çfarë kishte shkruar babai dhe se çfarë kishte menduar kur ishte në moshën në të cilën isha unë. Nuk m'u desh shumë kohë të kuptoja se nuk do të gjeja asgjë të tillë aty. Ajo që më bezdiste më shumë ishte atëherë kur, aty-këtu në shënimet e babait, hasja në zërin e tij prej shkrimitari. Ky nuk ishte zëri i babait tim, i thosha vetes; nuk ishte autentik apo, të paktën, nuk i përkiste njeriut që unë e kisha njobur si babanë tim. Prapa frikës sime se babai im mund të mos ketë qenë babai im kur kishte shkruar, ishte një frikë edhe më e thellë: frika se thellë në veten time unë nuk isha autentik, se në shkrimet e babait nuk do të gjeja të mirë, kjo ma shtonte frikën të shihja babanë tim të ndikuar si tepër nga shkrimitarë të tjerë dhe më zhyste në dëshpërim që më kishte kapluar aq keq kur isha i ri, duke vënë jetën time, vetë ekzistencën time, dëshirën time për të shkruar dhe punën time në dyshim. Gjatë dhjetë vjetëve të mia të para si shkrimitar e

ndieja këtë shqetësim thellë e më thellë dhe, edhe kur e tejkalova atë, nganjëherë ndieja frikën se një ditë do të isha i detyruar ta pranoja disfatën - mu ashtu siç kisha bëre me pikturen - dhe t'i dorëzoheshë shqetësimit, duke hequr dorë edhe nga shkrimi i romaneve. Kam zënë në gojë tashmë dëgjat jetët që i kishin lindur në mua kur po mbyllja valixhen a babait dhe kur po e hidhja mënjanë: ndjenja e të qenit i braktisur në provinca dhe frika se më mungonte autentiteti. Kjo assesi nuk ishte hera e parë që këto ndjenja më kishin bëre të ndihesha kësosoj. Me vite, në leximet dhe shkrimet e mia, kisha studiuar, zbuluar, kisha thelluar këto ndjenja në të gjitha variantet dhe pasojat e paqëllimita, përfundimet e tyre nervore, cytjet e tyre dhe ngjyrat e tyre të shumta. Pa dyshim, shpirti më ishte acaruar nga konfuzioni, ndjesitë dhe dhembjet e dendura qëjeta dhe librat më kishin hedhur, të shumtën kur isha i ri. Por vetëm përmes shkrimit të librave arrita të kisha një kuptim më të plotë të problemeve të autenticitetit (si tek "Quhem i kuqi" dhe "Libri i zi"), si dhe të problemeve të jetës në periferi (si tek "Bora" dhe "Stamboll"). Për mua të jesh shkrimitar do të thotë t'i njobësh plagët e fshehta që bartim përbrenda, plagë aq të fshehta saqë as ne vetë nuk jemi të vetëdijshëm për to dhe që t'i shqyrtoш ato me durim, t'i njobësh, t'i përndriçosh, t'i

posedosh këto dhembje dhe plagë dhe t'i bësh pjesë të vetëdijshme të shpirtit dhe të shkrimeve tonë.

Shkrimitari flet për gjëra që secili i di, por që nuk e di se i di. Të hulumtosh këtë njoburi dhe ta shikosh atë duke u rritur, eshtë një gjë e këndshme; lexuesi udhëton në një botë që eshtë sa e njobur aq dhe e mrekullueshme. Kur një shkrimitar mbyll veten në një dhomë me vite të tëra për ta mprehur zanatin e vet - për të krijuar një botë - nëse ai shfrytëzon plagët e tij të fshehta si pikënisje, ai eshtë, e diti apo nuk e diti, duke treguar besim të madh në njerëzinë. Besimi im vjen nga bindja se të gjitha qeniet njerëzore i njëjanë njëratjetrës, se të tjerët bartin plagë të ngjashme me të miat - prandaj do të kuptojnë. E tërë letërsia e vërtetë vjen nga kjo siguri fëmijërore dhe shpresë-dhënëse se të gjithë njerëzit i njëjanë njëratjetrës. Kur një shkrimitar mbylli në një dhomë me vite, me këtë gjest ai sugjeron një njerëzi të vetme, një botë pa qendër.

Por, siç mund të shihet nga valixhja e babait tim dhe ngjyrat e zvetënuara të jetës sonë në Stamboll, bota kishte një qendër dhe ajo ishte larg prej nesh. Në librat e mi e kam pëershkuar në detaje se ky fat i thjeshtë kishte evokuar te ne një ndjenjë çehoviane të provincialitetit dhe se si, përmes një rruge tjetër, kjo më kishte bëre të viaj në dyshim autenticitetin tim. E di nga

përvoja se pjesa dërrmuese e njerëzve të kësaj toke jetojnë me po këto ndjenja dhe se shumë prej tyre vuajnë nga një ndjenjë ende më e thellë e pamjaftueshmërisë, mungesës së sigurisë dhe ndjenjës së poshtërimit sesa unë. Po, dilemat më të mëdha me të cilat ballafaqohet njerëzimi janë ende mungesa e tokës, mungesa e kulmit mbi kokë dhe uria... Por sot televizioni dhe gazetat tonë na flasin për këto probleme themelore më shpejt dhe më thjesht nga c'mund ta bëjë këtë ndonjëherë letërsia. Ajo për të cilën sot ka nevojë ta thotë dhe ta hulumtojë letërsia janë frikët themelore të njerëzimit: frika nga braktisia, frika nga injorimi i plotë dhe ndjenjat e pavlerës që burojnë nga frikë të tilla; poshtërimet kolektive, lëndimi, shpërfilljet, pikëllimet, fyerjet e imaginuara, lavdërimet dhe fryrjet nacio-naliste që janë të afërtë me to... sa herë që ballafaqohem me sentimente të tilla dhe me gjuhë irrationale, të mbitheksuar, në të cilën shpesh shprehen ato, e di se prekin të errëtë brenda meje. Shpesh kemi hasur në njerëz, shoqëri dhe kombe jashtë botës perëndimore - dhe unë lehtë mund të identifikohem me ta - të cilët gjunjëzohen para frikave që shpesh i shpijnë drejt marrëzive, mu për shkak të frikës së tyre nga poshtërimi dhe ndjeshmëritë e tyre. E di, po ashtu, se në Perëndim - një botë me të cilën unë mund të identifikohem me po aq lehtësi -

vendet dhe popujt që lavdërohen së tepërmë me begatinë e tyre, duke u mburrur se ata kanë sjellë renesancën, iluminizmin, modernizimin, janë gjunjëzuar herë pas herë para një vetëkënaqësie, që është po aq e marrë.

Kjo do të thotë se babai im nuk ishte i vetmi të cilit po i japid tepër rëndësi për idenë e botës me një qendër. Ndërkaq, ajo gjë që na detyron ta mbyllim veten në dhomat tona për të shkruar me vite të tëra, është besimi në të kundërtën, besimi se një ditë shkrimet tona do të lexohen dhe do të kuptohen, ngaqë njerëzit gjithandje botës i ngjajnë njëri-tjetrit. Po kjo, siç e di nga shkrimet e mia dhe nga ato të babait tim, është një optimizëm i trazuar, i përcëlluar nga zemërimi i të qenit të kufizuar në margjina, nga të qenit i përjashtuar. Dashurinë dhe urrejtjen që ndiente Dostoevski ndaj Perëndimit, gjatë tërë jetës së tij, e kam ndier edhe vetë, në shumë raste. Por, po qe se kam zënë një të vërtetë esenciale, nëse kam arsyë për optimizëm, kjo është ngaqë kam bërë udhë me këtë shkrimtar të madh përmes relacionit të tij dashuri-urrejte me Perëndimin, për ta parë atë botë tjetër që ai ka ndërtuar në anën tjetër.

Të gjithë shkrimtarët që i kanë dedikuar jetën kësaj detyre njohin këtë realitet: pa marrë parasysh qëllimin tonë fillimtar, bota të cilën ne e krijojmë pas shumë e shumë vitesh shkrimesh shpresëdhënëse, më në fund, do të kalojë në vende fare të ndryshme. Ato do të na çojnë larg nga tavolina, pranë së cilës kemi punuar me pikëllim apo zemërim, do të na nxjerrin tek ana tjetër e atij pikëllimi apo zemërimi, në një tjetër botë. A nuk ka mundur babai im të arrinte deri te një botë e tillë përveten e tij? Sikur dheu që merr gradualisht formën, duke dalë ngadalë nga mjegulla në tërë ngjyrat e tij, si një ishull pas një lundrimi të gjatë në det, kjo botë tjetër na magjeps. Ne nemi-temi mu sikur udhëtarët perëndimore që qasen nga jugu për ta parë Stambollin duke dalë nga mjegulla. Në mbarim të një udhëtimi të filluar me shpresë dhe kureshtje, para tyre qëndron një qytet xhamish dhe minaresh, një përzierje shtëpish, rrugësh, kodrash, urash dhe shpatesh, një botë e tërë. Duke parë këtë, ne dëshirojmë të zhytemi në këtë botë dhe të humbim brenda saj mu ashtu siç do të zhyteshim në një libër. Pasi të jemi ulur pranë një tavoline, ngaqë ndiheshim provincialë, të përjashtuar, në margjina, të zemëruar, apo tepër të mallëngjyer, ne gjejmë një botë të tërë përtëj këtyre ndjenjave.

Ajo që ndiej tanë është e kundërtë e asaj që kam ndier si fëmijë dhe si i ri: për mua, qendra e botës është Stamboll. Kjo nuk është vetëm ngaqë aty e

kam kaluar tërë jetën time, por ngaqë gjatë 33 vjetëve të fundit unë kam rrëfyer për rrugët e tij, për urat, njerëzit, qentë, shtëpitë, xhamitë, shatërvanët, heronjtë e tij të çuditshëm, dyqanet, karakteret e tij të njojur, skutat e errëta, ditët dhe netët e tij, duke i bërë këshu pjesë të vetes sime, duke i përaqfuar që të gjitha. Arri i një pikë kur kjo botë, të cilën unë e kisha ndërtuar me duart e mia, kjo botë që ekziston time vetëm në kokën time, ishte më reale përmua sesa vetë qyteti në të cilin unë jetoja në të vërtetë. Kjo ndodhi atëherë kur të gjithë këta njerëz dhe këto rrugë, këto objekte dhe ndërtesa, sikur kishin zënë të flisin midis tyre dhe të ndërvepronin në mënyrë që unë nuk e kisha pritur, sikur të mos kishin jetuar vetëm në imagjinatën time apo në librat e mi, por përveten e tyre. Kjo botë që kisha krijuar unë si dikush që mih një pus me një gjilpërë më dukej atëherë më e vërtetë se çdo gjë tjetër.

Im atë mund ta ketë zbuluar, po ashtu, këtë lloj lumturie gjatë viteve që ai i kalonte duke shkruar, mendoja unë, sa herë i hidhja sytë valixhes së babait: nuk duhej ta paragjykoja. I isha aq mirënjohnës, para së gjithash: ai nuk kishte qenë asnëjëherë baba që jepte urdhra, që ndalonte, që mbizotëronte, që ndëshkonte, një baba i rëndomtë, por një baba i cili gjith-monë më la të lirë, që gjithmonë tregonte përmua respektin më të madh. Kam vrarë mendjen shpesh se, sikur herë pas herë, kam qenë në gjendje ta nxirja nga koka, qoftë në rini apo fëmijëri, kjo ndodhët ngaqë jo si shumica e shokëve të mi të fëmijërisë dhe rinisë, unë nuk kisha frikë nga babai im, dhe nganjëherë kam besuar thellësisht se unë kam qenë në gjendje të bëhem shkrimtar, ngaqë babai im, në rinnë e tij, kishte dëshiruar të bëhej edhe vetë. Më duhej ta lexoja me tolerancë, të përpinqesha ta kuptoja se çfarë kishte shkruar në ato dhoma hoteli.

Me këto mendime shprese në kokë iu afrova valixhes, që ende qëndronte aty ku e kishte lënë babai. Mblodha të tërë fuqinë e mendjes për të lexuar disa dorëshkrime dhe shëname. Përfshirë kishte shkruar babai? Më kujtohen disa përshkrime nga ditaret e hoteleve të Parisit, disa vjersha, paradoxë, analiza... Tani kur po e shkruaj këtë, ndihem sikur dikush që porsa ka shpëtuar nga një aksident trafiku dhe që përpinqet të kuptojë se si ndodhi dhe që, në të njëjtën kohë, duke iu druar kujtimit të tepërt. Kur kam qenë fëmijë dhe kur babai dhe nëna ime ishin para grindjes, kur ata binin në atë heshtjen e tyre përvdekje, im atë menjëherë e lëshonte radion përmes tij, dëshiruar disponimin dhe muzika na bënte të harronim

më shpejt të tën.

Më lejoni të ndërroj disponimin me disa fjalë të embla të cilat, shpresoj, do të shërbijnë po aq sa dhe ajo muzikë. Siç e dini, pyetja që na bëjnë ne shkrimtarëve më së shpeshti, pyetja e dashur, është, pse shkruani? Unë shkruaj ngaqë kam një nevojë të brendshme për të shkruar! Shkruaj ngaqë nuk mund të bëj punë normale si njerëz të tjerë. Shkruaj ngaqë dua të lexoj libra si ato që shkruaj unë. Shkruaj sepse jam i zemëruar në të gjithë ju, i zemëruar me të gjithë. Shkruaj ngaqë më pëlqen të rri ulur në dhomë tërë ditën e të shkruaj. Shkruaj ngaqë unë jam në gjendje të jem pjesë e jetës së vërtetë vetëm duke e ndryshuar atë. Shkruaj ngaqë dua që të tjerët, të gjithë ne, e tërë bota, të dijë se në çfarë jete kemi jetuar dhe vazhdojmë të jetojmë në Stamboll, në Turqi. Shkruaj ngaqë ma ka ëndë aromën e letërës, lapsit dhe ngjyrës. Shkruaj ngaqë besoj në letërsi, në artin e romanit, më shumë nga ç'besoj në çdo gjë tjetër. Shkruaj ngaqë kjo më është bërë ves, pasion. Shkruaj ngaqë kam frikë nga të qenit i harruar. Shkruaj ngaqë më pëlqen lavdi dhe interesimi që sjell të shkruarit. Shkruaj që të jem vetëm. Ndoshta shkruaj ngaqë shpresoj të kuptoj pse jam kaq shumë i zemëruar me të gjithë ju, kaq shumë i zemëruar me secilin. Shkruaj ngaqë dua që të jem i lexuar. Unë shkruaj ngaqë kur të kem filluar një roman, një ese, një faqe, dua që ta mbaroj. Shkruaj ngaqë të gjithë presin nga unë që të shkruaj. Shkruaj ngaqë kam një besim fëmijëror në pavdekësinë e bibliotekave dhe në mënyrën se si rrinë librat në rafte. Shkruaj jo që të rrëfej një tregim, por që të krijoj një tregim. Shkruaj ngaqë dua të iki nga parandjenja se ka një vend ku duhet të shkoj, por që - si një ndërrë - nuk mund të zë vend atje. Shkruaj ngaqë nuk ia kam dalë asnëjëherë të jem i lumtur. Shkruaj që të jem i lumtur.

Një javë pasi kishte hyrë në zyrën time dhe më kishte lënë valixhen, im atë erdhi për të më bërë edhe një vizitë. Si gjithmonë, edhe këtë herë më kishte sjellë një çokollatë (kishte harruar se kisha mbushur 48 vjet). Si gjithmonë, llafosem dhe qeshëm me jetën, politikën dhe thashethemet familjare. Arri i një çast kur sytë e babait u kthyen nga skuta ku ai e kishte lënë valixhen dhe e vërejti se unë e kisha lëvizur atë. Shikuam njëri-tjetrin në sy. Nuk ia thashë se e kisha hapur valixhen dhe isha përpjekur ta lexoja përbajtjen e saj, në vend të kësaj, m'u thye shikimi. Por, ai e kuptoi. Mu ashtu siç e kuptova se ai e kishte kuptuar. Mu ashtu siç kuptoi ai se e kisha kuptuar se ai e kishte kuptuar. Por, ky të kuptuar vajti vetëm për aq sa mund të shkojë përkakus.

sekonda, ngaqë babai ishte një i gjëzuar, i lehtë, që kishte besim në vërvete, ai vëtëm buzëqeshi, ashtu siç më buzëqeshi gjithmonë. Dhe, kur po ikte nga shtëpia, ai përsëriti ato gjëra të bëjnë ne shkrimtarëve më së shpeshti, pyetja e dashur, është, pse shkruani?

Si gjithmonë, po e shikoja të ikte, duke ia pasur lakmi për lumturinë e tij, për temperamentin e tij të shkujdesur dhe gjaktohtë. Por më kujtohet se atë ditë kishte edhe një ndjenjë gjëzimi brenda meje që më bënte të turpërohesh. Ajo shkaktohej nga mendimi se, mbas, unë s'isha aq i rehatshëm në jetë nga ç'kishte qenë ai, mbas nuk kisha bërë një jetë aq të lumtur dhe aq të lehtë sa ai, por se ia kisha kushtuar atë shkrimit - ju e kuptioni... Më vinte turp të mendoja gjëra të tilla në llogarinë e babait tim. Nga të gjithë njerëzit, im atë, i cili nuk kishte qenë kurrë burim i dhembjeve të mia - (që më kishte lënë të lirë. E tërë kjo duhet të na e kujtoj se shkrimi dhe letërsia janë ngushtë të lidhura me një mangësi në qendër të jetës sonë dhe me ndjenjat e lumturisë dhe fajit).


Por tregimi im ka një simetri që më rikujtoi aty për aty diçka tjetër atë ditë dhe që më solli një ndjenjë edhe më të thellë të fajit. Njëzet e tre vjet pasi që babai im më la valixhen e tij, dhe katër vjet pasi e kisha vendosur, në moshën 22-vjeçë, të bëhesha romancier dhe pasi kisha braktisur çdo gjë tjetër, pasi që u mbylla në një dhomë dhe mbarova romanin tim të parë, Xhevdet bezë dëshiroja që ai të ishte një mesin tonë.

lexonte dhe të më thoshte se çfarë mendonte. Kjo nuk ishte thjesht ngaqë kisha besim në shijen e tij dëshirës sime për t'u bërë shkrimtar. Në atë pikë babai im nuk ndodhej me ne, ishte larg. Unë e prita me padurim të kthej. Pasi u kthy, dy javë më vonë, vrapova t'a hapja derën. Babai nuk tha gjë, por më përqafroi ashtu që më bëri të ditur se i kishte pëlqyer shumë. Për një çast, ne kishim rënë në njëfarë heshtjeje të përçudshme që shpesh përçon çastet e emocioneve të mëdha. Pastaj, kur kishim pushuar dhe zumë të flisnim, babai u pushtua nga një gjuhë e ngarkuar dhe ekzagjeruese për ta shprehur besimin e tij në mua apo romanin tim të parë: ai më tha se një ditë do ta merri çmimin për të cilin jam këtu përtë marrë me një lumturi kaq të madhe. Ai e tha këtë jo ngaqë po përpinqej të më bindte për mendimin e tij të mirë, apo për të vënë këtë çmim si qëllim. Ai e tha këtë si një baba turk që mbështet të birin, duke i dhënë kurajë me fjalët, 'një ditë ti do të bëhesh pasha!'. Me vite, sa herë që më shihte, më inkurajonte me të njëjtat fjalë.

Babai më vdiq në dhjetor 2002.

Sot, kur po qëndroj para Akademisë Suedeze dhe para anëtarëve të dalluar që më kanë dhënë këtë çmim të madh - këtë nder të madh - dhe të ftuarit e tyre të dalluar, sa do ta dëshiroja që ai të ishte një mesin tonë.

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". Përktheu: Avni Spahiu)





Fillojnë Lojërat Olimpike, parakalojnë Kosova dhe Shqipëria



PRISHTINË, 23 KORRIK - Kanë filluar Lojërat Olimpike "Tokio 2020" në të cilat marrin pjesë më shumë se 11 238 atletë nga 204 shtete. Këta sportistë do të garojnë në 33 sport dhe 50 disiplina. Covid-19 ka kushtëzuar organizimin ku në ceremoninë hapëse pjesëmarrës ishin rreth 1 000 persona, ku shumica prej tyre funksionarë dhe të ftuar. Organizatorët u kujdesën t'i tregonin të gjithë botës se sa e vështirë ka qenë të besh sport këtë periudhë, ku sportistët ishin të detyruar të stërviteshin në shtëpitë e tyre për shkak të karantinës. Më në fund jeta iu rikthyte normalitet dhe këto Lojëra Olimpike janë mesazhi më qartë që jeta vazhdon. Kosova për

herë të dytë në histori të saj merr pjesë në Lojërat Olimpike, kurse ekipi i Kosovës i prirë nga Majlinda Kelmendi dhe Akil Gjakova parakaloi si shteti i 67, me tetë sportistë dhe gjashtë trajnerë e zyrtarë.

Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, është shprehur krenare që ka parë parakalimin e sportistëve nga Kosova në Lojërat Olimpike "Tokio 2020". "Nder e krenari ta shoh parakalimin e 11 sportistëve të Republikës së Kosovës të cilët po marrin pjesë në Lojërat Olimpike në Tokio. Populli i Kosovës është krenar me ju, beson më përgatitjen tuaj, suksesin tuaj dhe triumfin tuaj. Sportistët tanë që

prej shumë kohësh po e ngrehin lart flamurin e shtetit të Kosovës, po na njallin shpresën dhe krenarinë se garat në sport nuk njohin shtete të mëdha e të vogla, por njohin sportistë të përgatitur, që me shpirtin garues thyejnë rekorde dhe bëjnë histori. Në krye me të artën tonë Majlinda Kelmendi, sportistëve tanë ju uroj sukses! Ata do ta bëjnë krenar veten dhe shtetin e Kosovës! Ju priftë e mbar! Një popull i tërë është me ju", ka thënë presidentja Osmani.

Ndërsa Shqipëria parakaloi në stadiumin olimpik të Tokios me mëntë sportistë elitarë, ku flamurin kuqezi e mbante dyshja Luiza Gega-Briken Calja.



SHKURT

Futbollisti nga Guinea përfalcon Dukagjinin

Skuadra e Dukagjinit nga Krina ka vazhduar përforcimet edhe të premten. Futbollisti nga Guinea, Moriba Tokpa Lamah, është lojtari më i ri që e përfalcon skuadrën që edicionin e ri do të bëjë gara në Superligë. "Futbollisti nga Guinea, Tokpa Moriba, është sulmues dhe vjen nga futbolli turk, ku ishte aktivizuar te grupmoshat e Denizlispor U19. I lindur më 30 dhjetor 2000, njëzetjeçari ka arritur që në vitin 2020 në kampionatin e grupmoshave U19 t'i realizojë mëntë gola në njëzet e katër paraqitje", thuhet në njoftimin e KF Dukagjini.

Janjeva vazhdon kontratën me KB Prishtina

Basketbollisti Muhamedali Janjeva e ka vazhduar kontratën me skuadrën e Prishtinës. Lajmi është bërë me dije nga KB Prishtina në faqen zyrtare në "Facebook". "Djali kampion i kryeqytetit, Muhamedali Janjeva, vazhdon kontratën me klubin e zemrës. Një ndër lojtarët kyç të sezont të kaluar Muhamedali Janjeva ka vazhduar kontratën me KB Sigal Prishtina. Muja do të jepë kontribut të madh edhe në këtë sezon. Faleminderit Mujo dhe të urojmë suksese!", thuhet në njoftimin e KB Prishtina.

Kollli, futbollist i ri i Shimizu S-Pulse

Reprezentues i Kosovës në futboll, Benjamin Kollli, do ta vazhdojë karrierën në Japoni te klubit Shimizu S-Pulse. Pas skadimit të kontratës me FC Zurich, Kollli kishte bërë me dije largimin, por jo destinacionin e radhës. Tani klubit japonez e ka konfirmuar lajmin për transferimin e Kolllit. "Jam shumë i ngazëllyer që do t'i takoj tifozët dhe të luaj në stadium para tyre në fanellën e portokalltë. Gjithashtu, jam i lumtur që kam ardhur në Japoni. Kam qenë shumë i interesuar në kulturën dhe ushqimin japonez", ka thënë Kollli.

Bardhi kërkohet nga Milani

Hakan Calhanoglu u largua me parametra zero nga Milani gjatë kësaj vere. Kuqezinjtë kanë nisur punën për zëvendësimin e tij, teksa në listë është edhe një futbollist me origjinë shqiptare. Enis Bardhi është një nga fantazistët më të talentuar në La Liga dhe kontrata i përfundon në verën e vitit 2022, teksha rinovimi me Levanten duket i vështirë. Bardhi synon t'i ngjise shkallët në karrierën e tij, teksha Milani shihet si destinacioni i duhur. Shifrat e transferimit mund të janë të përballueshme edhe për kuqezinjtë.

Kosova përballet me Luksemburgun

PRISHTINË, 23 KORRIK - Basketbollistët e Kosovës U20 (M) në fundjavë do të luajnë përvendet 5-8 në kuadër të FIBA European Challengers që po mbahet në Hungari. Kosova

U20 përfundoi e fundit në grupin e saj me tri humbje ndaj Bjellorusisë, Hungarise dhe Sllovakisë, ndërsa sot (e shtunë) nga ora 15:00 do të përballet me Luksemburgun

përvendet 5-8. Varësisht nga rezultati i së shtunës, "dardanët" e rindë pas do të luajnë përvendet e pestë ose të shtatin, takim që zhvillohet të dielën, ditën që përfundon

ky kampionat. Ndërkohë, Luksemburgu përfundoi grupin me dy fitore dhe një humbje. Luksemburgu mund Zvicrën dhe Rumaninë, kurse pësoi nga Maqedonia e Veriut.



Sot takohen Kosova dhe Irlanda

PRISHTINË, 23 KORRIK - Basketbollistet e Kosovës A sot (e shtunë) do të përballen me Irlandën në gjysmëfinale të Kampionatit Evropian përvendet 5-8 në Vogla. Takimi do të zhvillohet nga ora 16:00 në Qipro, aty ku po zhvillohet ky kampionat. Kosova ishte në Grupin B, ku përfundoi e dyta, me një fitore ndaj Qipros 68:70 dhe një humbje nga Luksemburgu 65:94. Luksemburgu përfundoi në vendin e parë në grup me dy fitore, kurse Qipro e fundit me dy humbje. Ndërkohë, Irlanda ka shënuar dy fitore në grupin e saj, duke mundur Andorrën 104:33 dhe Maltën 48:78. Përvendet 5-8 Kosovën A kjo është hera e parë që paraqitet në një garë ndërkombëtare. Edhe pse takimi ndaj Irlandës vlerësohet i vështirë, nuk mungon motivimi në kampin e Kosovës. Kosova pas dy ndeshjeve në dy ditët e para po stërvitet që të jetë sa më e gatshme përvendet përballe



vashave irlandez. Gjysmëfinalja tjetër është mes Luksemburgut dhe Maltës që zhvillohet të shtunën me

fillim nga ora 19:00. Ndesha finale dhe ajo përvendet e tretë zhvillohet të dielën.

Barça kërkon të largojë 11 futbollistë përvendet 255 milionë euro

BARCELONA, 23 KORRIK - Barcelona ka investuar shumë në merkato në vitet e fundit, por investimet nuk është se janë shpërblyer, madje tashmë janë kthyer në rëndesë përvendet klubin. Bëhet fjalë përvendet 11 futbollistë të cilët nuk bëjnë më pjesë në planet e klubit katalan dhe kanë përfunduar në shitje. Vetëm përvendet dy prej tyre, Antoinne Griezmann dhe Philippe Coutinho, drejtuesit e Barcelonës paguan plot 255 milionë euro t'i sjellë në "Camp Nou". Gjithçka nis nga portieri uruguayan Neto, i cili ka kërkuar largimin dhe kartoni i tij vlerësohet vetëm 8 milionë euro, por asnjë klub nuk ka trokitur në dyert e Barcelonës përvendet 68 milionë euro. Nuk mbetet mbrapa as sulmi, pasi dy kampionët e botës me Francën, Antoninne Griezmann e Ousmanne Dembele, të cilët kanë



tyre në treg është rrëth 68 milionë euro. Nuk mbetet mbrapa as sulmi, pasi dy kampionët e botës me Francën, Antoninne Griezmann e Ousmanne Dembele, të cilët kanë

edhe paga shumë të larta. Në total një formacion i plotë, një 11-she e frikshme, përvendet cilët Barcelona nuk arrin të arkëtojë dot as 255 milionë eurot e vlerës së tyre në treg.

Xhudisti algjerian tërhiqet nga Olimpiada pasi nuk donte të përballej me rivalin nga Izraeli

Xhudisti algjerian Fethi Nourine është tërhequr zyrtarisht nga Lojërat Olimpike "Tokio 2020" para se ta nisë garën e tij. Ai mori këtë vendim

pasi shorti në peshën 73 kg, me shumë gjasa, do ta vinte përballe një rivali nga Izraeli, Tohar Butbul. Nourine do të përballej të hënën fillimisht me

rivalin nga Sudani, Mohamed Abdalrasool (në duelin e parë) dhe më pas me izraelitin Butbul. Duke folur përvendet, algeriani konfirmoi se ky është

një vendim politik i marrë nga ai, në mbështetje të Palestinës. "Kam punuar shumë përvendet ardhur në Olimpiadë, por çështja palestinezë është më e

madhe se gjithë kjo", ka thënë sportisti algjerian. Ky vendim i sportistit u konfirmua më vonë edhe nga trajneri i tij, që e vlerësoi se ishte gjëja e duhur.

SHKURT

Benzema del pozitiv në testin përvendet Covid-19

Sulmuesi Karim Benzema ka rezultuar pozitiv me koronavirus. Lajmi është konfirmuar nga skuadra e Real Madridit. Lojtari nuk ka tanë përvendet simptoma, por do të qëndrojë i izoluar së paku dy javë. Kjo do të thotë se Benzema s'do t'i bashkohet këtë javë Realit në parasezon, ai duhet të presë edhe së paku dy javë, derisa të rezultojë negativ përvendet i nisur stërvitet e para me trajnerin Carlo Ancelotti.

Unitedi 'rrëmben' Varanen nga Reali

Duket se është arritur një marrëveshje në vija të përgjithshme mes Manchester Unitedit dhe Raphael Varanes. Sipas "Telefoot", Unitedi ka rënë dakord me kampionin e botës dhe tanë do të duhet të arrijë një marrëveshje me "Los Blancos". Sipas mediave, Manchester Unitedi është gati të paguajë 60 milionë euro përvendet yllin e Real Madridit. Ai i ka fituar të gjitha me Real Madridin, duke përfshirë tre tituj në La Liga dhe Ligën e Kampioneve në katër raste të ndara. Përvendet spanjollë do të jetë e kushtueshme humbja e Varanes përvendet verën e ardhshme.

Tottenhami 'blindon' Sonin

Heung-Min Son ka nënshkruar kontratë të re me Tottenham Hotspur. Kapiteni i Koresë së Jugut ka nënshkruar kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2025. Son është pjesë e Tottenhamit tash e gjashtë vjet. Ai ishte transferuar në vitin 2015 nga Bayer Leverkuseni, teksha me skuadrën londinezë ka shënuar 107 gola dhe 64 asistime në 280 paraqitje. "Tashmë ishte një nder i madh të luaj këtu përvendet gjashtë vjet. Klubi më ka treguar respekt masiv dhe padishim që jam shumë i lumtur që jam këtu. Është si në shtëpi, veçanërisht me tifozët, lojtarët, stafin. Jam shumë i lumtur që jam këtu dhe do të jem shumë i lumtur t'i shoh përsëri fansat së shpejti", ka thënë Son.

Sancho edhe zyrtarisht tek Unitedi

Marrin fund burokracitë, Jadon Sancho është lojtari më i ri i Manchester Unitedit. Pas shumë kohësh pritje, më në fund ka ardhur edhe zyrtarisht t'i transferimit të 21-vjeçarit drejt "djave të kuq". Sancho ka firmosur përvendet pesë vjet me Unitedin dhe do të fitojë shumën stratosferike të 18 milionë paundësh në vit, çka i bie rrëth 375 mijë paund në javë. Shifra të frikshme këto përvendet një lojtar t'i ri, por sulmuesi anglez cilësohet si një prej talentëve më të mëdhenj në futboll. Lajmin e bëri me dije vetë faqja e Manchester Unitedit në "Twitter" duke i uruar mirëseardhje Sanchos.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[facebook](#)

www.facebook.com/gjejpuneshejte

Lume's Details

Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](#)

Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Avdyl Avdyli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV si dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Hanemshah Halili nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit " Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe koridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë se pse shtëpia ka nevojë përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërrlok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhamet Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banës me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhamet Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banës me qera në lagjen "Mati 1" përboll "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banës me qira garsoniere në Ulpianë kati i parë, posedon tre shtretër dhe i mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banës me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banës me qira në Lagjen Dardania afér "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banës me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banës me qira në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshoj banës me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banës me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afér Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banës me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afér Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banës e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m². Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banës me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banës një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afér Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banës e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrore dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afér AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten free

100 % mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues